

LIGJ
Nr. 155/2020

PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE¹

(Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024; nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të kontribuojë në uljen e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë;
- b) të përshpejtojë përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, me synim zbutjen e efekteve të dëmshme të ndryshimeve klimatike;
- c) të kontribuojë në përpjekjet globale ndaj ndryshimeve klimatike nëpërmjet plotësimit të detyrimeve të Republikës së Shqipërisë ndaj Konventës;
- ç) të krijojë një kuadër gjithëpërfshirës ligjor dhe ndërinstitutional për ndërmarrjen e veprimeve ndaj klimës në nivel kombëtar në përputhje me legjislacionin e BE-së për ndryshimet klimatike.
- d) t'u bashkohet shteteve që njohin emergjencën klimatike, sipas vendimit të Parlamentit Evropian të 28 nëntorit 2019.

Neni 2

Fusha e zbatimit

¹ Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

- Direktivën 2003/87/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 tetor 2003, “Për krijimin e një skeme për tregtinë e lejeve për shkarkimet e gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit dhe që ndryshon Direktivën e Këshillit 96/61/KE”, e ndryshuar. Numri CELEX 32003L0887, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 275, datë 25.10.2003, f. 32–46.

- Rregulloren (BE) nr. 525/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 maj 2013, “Mbi mekanizmin e monitorimit dhe raportimit të shkarkimeve të gazeve me efekt serrë dhe për raportimin e informacioneve të tjera që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar dhe të Bashkimit Evropian, që shfuqizon vendimin nr. 280/2004/KE”, të ndryshuar”, Numri CELEX 32013R0525, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 165, datë 18.6.2013, f. 13–40.

Ky ligj përcakton:

- a) kuadrin e përgjithshëm të politikës kombëtare për veprime ndaj ndryshimeve klimatike;
- b) kushtet e shkarkimeve të gazeve serrë nga burimet e palëvizshme e të lëvizshme, nga produktet dhe substancat;
- c) kushtet e kapjes dhe të depozitimit gjeologjik të dyoksidit të karbonit;
- ç) kuadrin e masave për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimeve të gazit me efekt serrë në nivelin e sektorëve/burimeve dhe në nivel kombëtar në përputhje me angazhimet kombëtare, financimet e brendshme dhe ndërkombëtare;
- d) kuadrin për pjesëmarrje në veprime ndërkombëtare të klimës;
- dh) ngritjen e sistemit institucional për ndërmarrjen e veprimeve ndaj ndryshimeve klimatike.

Neni 3

Përkufizime

(Ndryshuar pika 34, shfuqizuar pika 12, shtuar pikat 4/1, 38, 39, 40, 41, 42, 43 dhe 44 me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Efekte të dëmshme të ndryshimeve klimatike” janë ndryshimet në mjedisin fizik apo biotë që rezultojnë nga ndryshimet klimatike, të cilat kanë efekte të rëndësishme negative mbi përbërjen, aftësinë vetëpërtëritëse, produktivitetin e ekosistemeve natyrore apo të menaxhuara, funksionimin e sistemeve social-ekonomike apo mbi shëndetin dhe mirëqenien e njeriut e të kafshëve blegtorale, si: gjedh, të imta, derra dhe njëthundrakë.

2. “Ndryshim klimatik” është një ndryshim i klimës, që i atribuohet direkt apo indirekt aktivitetit të njeriut, i cili ndryshon përbërjen e atmosferës globale dhe që i shtohet ndryshueshmërisë natyrore të klimës, që vërehet në periudha kohe të krahaseshme.

3. “Sistem i klimës” është tërësia e atmosferës, hidrosferës, biosferës e gjeosferës dhe ndërveprimeve të tyre.

4. “Shkarkime” janë çlirimet nga aktivitetet antropogjene të GES-it dhe/ose prekursorëve të tyre në atmosferë, në një sipërfaqe dhe periudhë kohe të caktuar.

4/1. “Shkarkime GES” janë çlirimet e gazeve me efekt serrë (GES) nga burimet e instalimit, që kryejnë aktivitetet e përfshira në shtojcën II, pjesa A; nga operatori i avionit, sipas përcaktimeve në shtojcën II, pjesa B; nga anija që kryen një veprimtari transporti detar dhe çliron GES-et e përfshira në shtojcën II, pjesa C, ose nga subjekti i rregulluar që kryen veprimtarinë e përmendur në shtojcën II, pjesa D.

5. “Rezervuar” është një përbërës apo përbërësit e sistemit të klimës ku depozitohet një GES apo një prekursor i GES-it.

6. “Përthithës” është çdo proces, aktivitet apo mekanizëm, që largon një GES, një aerosol ose një prekursor të GES-it nga atmosfera.

7. “Burim” është çdo proces apo aktivitet që çliron një GES, një aerosol apo një prekursor të GES-it nga atmosfera.

8. “Konventa” është Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, miratuar në Nju Jork më 9 maj 1992, që ka hyrë në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 1 janar 1995 dhe ku Republika e Shqipërisë është palë jo e shtojcës I.

9. “Protokolli i Kiotos” është Protokolli i Kiotos i Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, miratuar në Kioto më 11 dhjetor 1997, që ka hyrë në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 30 qershor 2005.

10. “Kapja dhe depozitimi gjeologjik i dyoksidit të karbonit (CO₂)” është një teknologji e ndërmjetme/lidhëse, që synon të kontribuojë në zbutjen e ndryshimeve klimatike. Ajo konsiston në kapjen e CO₂ nga instalimet industriale, transportin e tij në një vend depozitimi

dhe injektimin në një formacion gjeologjik të përshtatshëm nën tokë, me qëllim ruajtjen e përhershme.

11. “Gaz me efekt serrë (GES)” janë gazet që gjenden në atmosferë në gjendje natyrale dhe të shkaktuara nga aktivitetet antropogjene, të cilat përthithin dhe rrimetojnë rrezatimin infra të kuq. Lista e GES-it të shkarkuar nga aktivitetet antropogjene, që mbulohen nga ky ligj, është në shtojcën I.

12. Shfuqizuar.

13. “Instalim” është një njësi teknike e palëvizshme, ku kryhen një apo më shumë aktivitete që bëjnë pjesë në shtojcën II, pjesa A e këtij ligji, dhe çdo aktivitet tjetër shoqëruar që ka lidhje teknike me aktivitetet e kryera në atë vendndodhje dhe që mund të ketë ndonjë efekt mbi shkarkimet dhe ndotjen;

14. “Ton ekuivalent dyoksid karboni” është një ton metrik dyoksid karboni (CO₂) ose një sasi e çfarëdo GES-i tjetër të listës në shtojcën I, që ka potencial ekuivalent për ngrohje globale.

15. “Djegje” është oksidimi i lëndës djegëse, pavarësisht mënyrës sesi përdoret nxehtësia, energjia elektrike apo mekanike e prodhuar nga ky proces, dhe çdo aktivitet tjetër që lidhet drejtpërdrejt me të, përfshirë pastrimin e mbetjeve të gazta;

16. “Politika dhe masa” janë të gjitha instrumentet që synojnë të zbatojnë angazhimet që lidhen me zbutjen e ndryshimeve klimatike, duke kufizuar shkarkimet antropogjene të GES-it dhe mbrojtjen e shtimit e përthithësve e të rezervuarëve dhe që mund të përfshijnë edhe ato që nuk kanë si objektiv parësor kufizimin dhe reduktimin e shkarkimeve të GES-it.

17. “Investime miqësore ndaj klimës” janë investimet në teknologji, që shkarkojnë pak karbon ose që çojnë në ripërtëritjen e klimës, drejt një ekonomie me pak karbon, që e kufizon ngrohjen globale në 2°C.

18. “Transferim i teknologjisë” është një tërësi procesesh që mbulojnë transferimin e njohurive teknike (*knoë - hoë*) të eksperiencës dhe pajisjeve për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen ndaj tyre ndërmjet aktorëve të ndryshëm, si: qeveritë, entet private, institucionet financiare, OJQ-të dhe institucionet kërkimore/arsimore.

19. “Integrim” është integrimi i objektivave, strategjive, politikave, masave apo operacioneve të zbutjes dhe/ose të përshtatjes, në mënyrë të tillë që ato të bëhen pjesë e politikave, të proceseve dhe buxheteve të zhvillimit rajonal e kombëtar në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat.

20. “Përshtatje” janë rregullimet e bëra nga njeriu në sistemet ekologjike, sociale, ekonomike ose proceset politike, në përgjigje të ndryshimeve aktuale apo të pritshme të klimës, efekteve apo ndikimeve të tyre.

21. “Zbutje” janë të gjitha përpjekjet e bëra për të reduktuar apo parandaluar shkarkimet e GES-it, përfshirë përdorimin e teknologjive të reja dhe energjive të rinovueshme, që i bëjnë pajisjet e vjetra më eficiente ndaj konsumit të energjisë, që ndryshojnë praktikën e menaxhimit apo sjelljen e konsumatorit.

22. “Operator” është sipas përcaktimit të dhënë në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.

23. “Operator avioni” është personi që operon një avion në kohën kur ai kryen një aktivitet aviacioni sipas përcaktimit të këtij ligji, me përjashtim të operacioneve të listuara në pjesën B të shtojcës II, ose, kur ky person është i panjohur ose i paidentifikuar nga pronari i avionit, vetë pronari i avionit.

24. “Operator i transportit ajror tregtar” është sipas përkufizimit në ligjin nr. 10 040, datë 22.12.2008, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

25. “Person” është çdo person fizik ose juridik.

26. “Publik” është një ose janë më shumë persona dhe, në përputhje me legjislacionin apo praktikën në fuqi, shoqata, organizata ose grupe personash.

27. “Ministri” është ministri përgjegjës për mjedisin.

28. “Ministria” është ministria përgjegjëse për mjedisin.
29. “AKM” është Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
30. “NDC” është dokumenti i kontributit tonë kombëtar të synuar, në linjë me përpjekjet globale për reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë (GES).
31. “Mekanizmi i zhvillimit të pastër (MZHP)” është një mekanizëm i bazuar në projekte, që buron nga Protokolli i Kiotos dhe që nxit partnershipin midis vendeve të zhvilluara dhe vendeve në zhvillim të Konventës për arritjen e objektivit final të saj, stabilizimin e GES-it në atmosferë.
32. “Sistemi i inventarit kombëtar” është sistemi i rregullimeve institucionale, ligjore dhe procedurale të bëra në Republikën e Shqipërisë për vlerësimin e shkarkimeve antropogjene nga burimet dhe përthithjen e tyre nga përthithësit e GES-it, të listuara në shtojcën I, si dhe për raportimin dhe arkivimin e informacionit të këtij inventari.
33. “Inventari i GES-it” është inventari i shkarkimeve, që përfshin shkarkimet e GES-it nga kategoritë e burimeve, si dhe përthithjen e tyre nga përthithësit e karbonit.
34. “IGJEO” është Instituti i Gjeoshkencave.
35. “Konventa e Aarhusit” është konventa për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit, ratifikuar me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000.
36. “Njësitë që përdorin ekskluzivisht biomasën” janë njësitë që përdorin lëndë djegëse fosile gjatë ndezjes apo fikjes së njësisë.
37. “Emergjencë klimatike” është një situatë në të cilën kërkohet veprim urgjent për të zvogëluar ose ndaluar ndryshimet klimatike dhe për të shmangur dëmet e mundshme të pakthyeshme mjedisore që rezultojnë prej saj.
38. “Efektet në aviacion, të palidhura me shkarkimin e CO₂” janë efektet në klimë nga çlirimi i oksideve të azotit (NO_x), i grimcave të blozës dhe i oksideve të squfurit gjatë djegies së karburantit dhe efektet nga avujt e ujit, duke përfshirë vijat e kondensimit (*contrail*) nga një avion që kryen një veprimtari aviacioni, të radhitur në shtojcën II, pjesa B.
39. “MRVA” është sistemi i Bashkimit Evropian që parashikon detyrimet e monitorimit, raportimit, verifikimit dhe akreditimit, në lidhje me shkarkimet e gazeve me efekt serrë për disa veprimtari specifike, që ngrihet në përputhje me direktivën 2003/87/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 13 tetor 2003, “Për krijimin e një skeme për tregtinë e lejeve për shkarkimet e gazeve me efekt serrë brenda Komunitetit dhe që ndryshon direktivën e Këshillit 96/61/KE.
40. “Lëndë djegëse”, për qëllimin e këtij ligji, është çdo produkt energjetik që përfshihet në listën e shtojcës II, pjesa D, të këtij ligji, që tregtohet dhe përdoret për djegie në sektorët e ngrohjes së ndërtesave, transportit rrugor, industrisë energjetike, industrisë së prodhimit dhe të ndërtimit, sipas specifikimeve teknike dhe përjashtimeve të përcaktuara në shtojcën II, pjesa D, të këtij ligji.
41. “Porti i zbarkimit” është porti ku një anije ndalon për të ngarkuar ose për të shkarkuar ngarkesë, për të ngjitur apo për të zbritur pasagjerë, ose porti ku një mjet lundrues në det të hapur (*offshore*) ndalon për të ndërruar ekuipazhin. Nuk përfshihen ndalesat që kanë si qëllim të vetëm furnizimin me karburant, marrjen e furnizimeve të tjera, ndërrimin e ekuipazhit të një anijeje, të ndryshme nga ajo në det të hapur, hyrjen në dok ose riparimin e anijes dhe/ose të pajisjeve të saj, ndalesat në port kur mjeti ka nevojë për ndihmë ose është në rrezik, transferimet nga anija në anije, të kryera jashtë porteve, ndalesat me qëllimin e vetëm për t’u strehuar nga moti i pafavorshëm ose që bëhen të domosdoshme për kryerjen e aktivitetit të kërkim-shpëtimit dhe ndalesat e anijeve të kontejnerëve në një port fqinj transporti kontejnerësh.
42. “Subjekti i rregulluar”, për qëllim të këtij ligji, është:
- a) shoqëria e tregtimit me shumicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, sipas përkufizimit të ligjit nr. 8450, datë 24.12.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin

e naftës, të gazit dhe të nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, që ushtron veprimtarinë e tregtimit me shumicë të produkteve të mëposhtme, kur përdoren si lëndë djegëse, në kuptim të shtojcës II, pjesa D, të këtij ligji:

- i. naftë bruto;
- ii. gaz natyror;
- iii. gaz i lëngshëm;
- iv. benzinë automjetesh;
- v. nënprodukte të tjera, të lëngshme, si benzol, toluol, ksilol, solven, *white spirit*;
- vi. gazoil (dizel);
- vii. vajgur ndriçues;
- viii. kerozene;
- ix. lëndë djegëse për përdorim termik civil dhe/ose industrial;
- x. vajra;
- xi. solarë;
- xii. bitum (asfalt);
- xiii. mazut.

b) çdo person fizik ose juridik që ushtron veprimtarinë e tregtimit me shumicë të produkteve të tjera, që konsiderohen dhe përdoren si lëndë djegëse, në kuptim të shtojcës II, pjesa D, të këtij ligji.

43. “Shoqëri transporti detar”, për qëllim të këtij ligji, janë subjektet detare sipas nenit 3 të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të të punësuarve.

44. “Lëndë djegëse alternative” do të thotë lëndë djegëse ose burime energjie që shërbejnë, të paktën pjesërisht, si zëvendësim për burimet e naftës fosile në energjinë e përdorur për transport dhe që kanë potencialin të kontribuojnë në dekarbonizimin e tij dhe të përmirësojnë performancën mjedisore të sektorit të transportit, duke përfshirë:

a) lëndë djegëse për automjete, trena, anije ose avionë me emetim zero të llojit:

- i. energji elektrike;
- ii. hidrogjen;
- iii. amoniak.

b) lëndë djegëse të rinovueshme dhe konkretisht:

i. karburante të biomasës, duke përfshirë biogazin dhe biokarburantet e përcaktuara në ligjin nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, si dhe në legjislacionin në fuqi për prodhimin, tregtimin, transportin e biokarburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse;

ii. lëndë djegëse sintetike dhe parafinike, duke përfshirë amoniakun, të prodhuara nga energjia e rinovueshme;

c) lëndë djegëse alternative jo të rinovueshme dhe karburante fosile kalimtare dhe konkretisht:

i. gaz natyror në formë të gaztë (gaz natyror i kompresuar (GNK)) dhe në formë të lëngëzuar (gaz natyror i lëngëzuar (GNL)), i përcaktuar në ligjin nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar;

ii. gaz naftë i lëngëzuar (LPG) që përbëhet nga hidrokarbure të lehta parafinike, të cilat rrjedhin nga proceset e rafinerisë, nga stabilizimi i naftës bruto dhe nga impiantet e përpunimit të gazit natyror, të përbëra kryesisht nga propani dhe butani ose kombinimi i të dyjave, që mund të përfshijnë edhe propilenin, butilenin, izopropilenin dhe izobutilenin;

iii. lëndë djegëse sintetike dhe parafinike të prodhuara nga energji jo e rinovueshme.

POLITIKA KOMBËTARE PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE

Neni 4

Objektivat dhe parimet

1. Me synimin për të zvogëluar efektet e dëmshme të ndryshimeve klimatike dhe për të kontribuar në përgjigjen globale ndaj tyre, objektivat kombëtarë për ndryshimet klimatike në Republikën e Shqipërisë janë:

a) zvogëlimi i shkarkimeve antropogjene të gazeve me efekt serrë në nivel kombëtar, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare;

b) rritja e aftësisë për t'u përshtatur ndaj efekteve të dëmshme të ndryshimeve klimatike, në nivel kombëtar, qendror e vendor;

c) ruajtja dhe rritja e përthithësve dhe rezervuarëve të gazeve me efekt serrë;

ç) nxitja e zhvillimit ekonomik nëpërmjet krijimit të vendeve të punës dhe konkurrencës, duke përfshirë edhe diversifikimin ekonomik dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;

d) pjesëmarrja graduale në zbatimin e politikës së ndryshimeve klimatike të Bashkimit Evropian.

2. Objektivat e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni zbatohen në funksion të parimeve të mëposhtme:

a) parimi i përgjegjësisë të përbashkëta, por të diferencuara, sipas të cilit të gjitha palët e Konventës, pavarësisht nëse janë vende në zhvillim apo të zhvilluara, marrin përgjegjësi për reduktimin e gazeve me efekt serrë sipas kushteve të secilit vend dhe brenda situatës së re ekonomike dhe politike të krijuar;

b) parimi i kujdesit paraprak, sipas të cilit masat duhen marrë, në radhë të parë, për të parashikuar, parandaluar apo minimizuar shkaqet e ndryshimeve klimatike dhe për të zbutur efektet e tyre të dëmshme;

c) parimi i eficiencës, sipas të cilit politikat dhe masat që merren për ndryshimet klimatike duhet të jenë me kosto efektive, në mënyrë të tillë që të sigurojnë përfitime globale me kostot më të ulëta të mundshme;

ç) parimi i integritit, sipas të cilit politikat dhe masat që merren për të mbrojtur sistemin e ndryshimit të klimës nga faktorët antropogjenë, si dhe përshtatja ndaj këtyre ndryshimeve duhet të përfshijnë të gjithë sektorët ekonomikë dhe të mbulojnë të gjitha burimet, përthithësit e rezervuarët e GES-it. Integrimi i ndryshimeve klimatike duhet bërë në të gjitha politikat dhe praktikatat ekzistuese e të ardhshme sektoriale e ndërsektoriale;

d) parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, sipas të cilit masat për mbrojtjen e sistemit të klimës nga ndryshimet antropogjene të integruara në politikën dhe programet e zhvillimit kombëtar duhet të çojnë në rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social të vendit;

dh) parimi i bashkëpunimit dhe financimit kombëtar dhe ndërkombëtar, sipas të cilit përpjekjet për të trajtuar ndryshimet klimatike mund të bëhen bashkërisht dhe në koordinim me vende të tjera të interesuara dhe, përveç buxhetit të shtetit, të mbështeten edhe nga burime financimi ndërkombëtare apo dypalëshe.

Neni 5

Strategjia dhe planet kombëtare për ndryshimet klimatike

(Ndryshuar me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

1. Kuadri i përgjithshëm kombëtar për ndryshimet klimatike përbëhet nga dokumentet e mëposhtme:

a) Strategjia Kombëtare Afatgjatë për Ndryshimet Klimatike dhe Zhvillimin me Emetim të Ulët, që përmban politikat e përgjithshme kombëtare për ndryshimet klimatike dhe ka si pjesë përbërëse të saj planin e veprimit afatgjatë për zhvillimin me emetim të ulët, që është në përputhje me objektivin e neutralitetit klimatik të Komunitetit të Energjisë, ku përcaktohen masat kombëtare për reduktimin e shkarkimeve të GES-eve dhe shtimin e përthithësve të GES-eve në sektorët përkatës;

b) Plani Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP), që krijon kuadrin për një proces të vazhdueshëm të përshtatjes në vend. NAP-i përcakton objektivat për përshtatjen, nxit integrimin e përshtatjes në politikat sektoriale të ministrive të linjës, përcakton masat prioritare dhe organizon përgjegjësitë e mekanizmat e bashkëpunimit brenda proceseve të përshtatjes;

c) Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën, i cili përmban elementet e parashikuara në pikën 3 të nenit 14 të këtij ligji.

2. Strategjia Kombëtare Afatgjatë për Ndryshimet Klimatike dhe Zhvillimin me Emetim të Ulët dhe pjesët përbërëse të saj, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij neni, përfshijnë çështjet nga lista joshtruese e shtojcës III/A, që i bashkëlidhet këtij ligji.

3. Ministria nëpërmjet grupit ndërmnistror të punës në fushën e ndryshimeve klimatike monitoron dhe vlerëson çdo 2 vjet progresin për zbatimin e Strategjisë Kombëtare Afatgjatë për Ndryshimet Klimatike dhe Zhvillimin me Emetim të Ulët dhe të Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP) dhe harton raportin që përmban:

a) vlerësimin e progresit në reduktimin e shkarkimeve dhe të përthithjes nga rezervuarët e GES-eve, në raport me kontributin kombëtar të përcaktuar (NDC);

b) vlerësimin e progresit në zbatimin e planit të veprimit afatgjatë për zhvillimin me emetim të ulët;

c) vlerësimin e zbatimit të Planit Kombëtar për Përshtatje ndaj Ndryshimeve Klimatike, që përfshin:

i. gjetjet e reja dhe vulnerabilitetin për ndryshimet klimatike;

ii. aktivitetet e kryera gjatë procesit të NAP-it;

iii. progresin dhe vështirësitë në integrimin e përshtatjes në sektorët e tjerë;

iv. progresin dhe vështirësitë në arritjen e objektivave e të indikatorëve;

v. rekomandimet për masat në të ardhmen.

4. Ministria, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energjinë, nëpërmjet grupit ndërmnistror të punës në fushën e ndryshimeve klimatike, monitoron dhe vlerëson çdo 2 vjet progresin për zbatimin e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës. Për këtë qëllim, ministrinë hartojnë raportin kombëtar të monitorimit të progresit të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, sipas procedurave të parashikuara nga mekanizmi qeverisës, i përcaktuar në pikën 2 të nenit 14 të këtij ligji.

5. Strategjitë dhe planet kombëtare për ndryshimet klimatike rishikohen sipas afateve të përcaktuara si më poshtë:

a) Strategjia Kombëtare Afatgjatë për Ndryshimet Klimatike dhe Zhvillimin me Emetim të Ulët rishikohet të paktën çdo 10 vjet;

b) Plani i veprimit afatgjatë për zhvillimin me emetim të ulët dhe Plani Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP) rishikohen të paktën çdo 5 vjet;

c) Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën rishikohet çdo 10 vjet, në përputhje me mekanizmin qeverisës, që parashikohet në pikën 2 të nenit 14 të këtij ligji. Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën rishikohet gjithashtu, në çdo rast, kur ka mospërputhje me arritjen e objektivave kombëtarë të miratuar apo kur synohet tejkalimi i tyre.

6. Strategjia Kombëtare Afatgjatë për Ndryshimet Klimatike dhe Zhvillimin me Emetim të Ulët dhe plani i veprimit afatgjatë për zhvillimin me emetim të ulët, si pjesë përbërëse e saj, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

7. Plani Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP) miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit.

8. Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën miratohet në përputhje me parashikimet e pikës 4 të nenit 14 të këtij ligji.

Neni 6

Integrimi i ndryshimeve klimatike në strategjitë sektoriale

1. Për të arritur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit, duke ndjekur njëkohësisht një rrugë me përdorim më pak intensiv të karbonit, ministritë e linjës dhe NJVQV-të me përgjegjësi shtetërore në fusha që kanë ndikim mbi/apo nga ndryshimet klimatike, kanë detyrimin:

a) të integrojnë çështjet e zbutjes e të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në legjislationin, strategjitë, planet, programet dhe projektet e tyre të zhvillimit, veçanërisht në sektorët e transportit, të energjisë, ujërave, bujqësisë dhe zhvillimit rural, zhvillimit urban dhe menaxhimit të fatkeqësive, si edhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;

b) të bashkëpunojnë për zbatimin e legjislationit, të strategjive, planeve, programeve dhe projekteve që trajtojnë ndryshimet klimatike;

c) të bashkëpunojnë për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e zbatimit të strategjive, planeve, programeve dhe projekteve që trajtojnë ndryshimet klimatike.

2. Masat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni kanë si qëllim të kontribuojnë në:

a) arritjen e angazhimit afatgjatë të vendit për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe rritjen e përthithjes nga përthithësit në të gjithë sektorët, sipas objektivit të caktuar në NDC, në mënyrë sa më eficiente;

b) identifikimin e masave të përshtatshme për uljen e vulnerabilitetit dhe rritjen e aftësive ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike të sektorëve përkatës dhe zbatimin e tyre;

c) monitorimin transparent dhe konsistent të progresit aktual dhe atij të planifikuar për të plotësuar angazhimet e vendit në Konventë.

3. Krahas kërkesave të tjera lidhur me formulimin e strategjive, procesi i integrimit të ndryshimeve klimatike në strategjitë sektoriale përfshin çështje nga lista joshteruese, sipas shtojcës III-B bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 7

Kontributi Kombëtar i Përcaktuar (NDC)

1. Dokumenti i NDC-së përcakton kontributin kombëtar për reduktimin e gazeve me efekt serrë përkundrejt arritjes së objektivit global të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, për mbajtjen e temperaturave në 2°C, duke kufizuar rrezikun e ardhshëm dhe kostot e përshtatjes ndaj ndryshimeve të klimës.

2. Kontributi Kombëtar i Përcaktuar rishikohet çdo 4 vjet dhe, nëse është e mundur, përditësohet me synimin për ta rritur objektivin e reduktimit të gazeve me efekt serrë në atë masë që lejojnë kushtet e vendit.

3. Ministria koordinon me grupin ndërministror të punës në fushën e ndryshimeve klimatike dhe, sipas rastit, edhe me aktorë të tjerë punën për zbatimin dhe rishikimin e dokumentit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

4. Metodologjia për hartimin dhe procesin e përgatitjes së dokumentit të NDC-së miratohet me udhëzim të ministrit, sipas modelit të miratuar ose të rekomanduar nga Konventa, në përputhje me kushtet e vendit.

5. Dokumenti “Përcaktimi i Kontributit Kombëtar” miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit dhe dorëzohet në sekretariatën e Konventës.

Neni 7/1

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike
(Shtuar me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

1. Ministria, vetë ose në bashkërendim me ministritë e sektorëve, e ndikuar nga ndryshimet klimatike, sipas rastit, harton politikat dhe kuadrin ligjor që sigurojnë rritjen e aftësive të përshtatjes, forcimin e qëndrueshmërisë, zvogëlimin e cenueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike, duke garantuar mbrojtjen e jetës, të mjeteve të jetesës dhe të ekosistemeve.

2. Politikat dhe kuadri ligjor, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, përmbajnë masat e nevojshme për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke përfshirë:

- a) masat për zgjerimin e njohurive shkencore dhe fuqizimin e kërkimit shkencor për klimën;
- b) masat për mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave për ndryshimet klimatike;
- c) masat për krijimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm për rreziqet që vijnë nga ndryshimet klimatike;
- ç) masat për përmirësimin e eficiencës dhe qëndrueshmërisë së veprimeve të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike;
- d) masat për ngritjen dhe fuqizimin e institucioneve kompetente për realizimin e veprimtarisë së përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike;
- dh) vënien në dispozicion të fondeve të posaçme për realizimin e masave të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.

KREU III

**SHKARKIMET E GES-it NGA BURIMET E LËVIZSHME E TË PALËVIZSHME,
PRODUKTET DHE SUBSTANCAT**

SEKSIONI I

**SISTEMI I MONITORIMIT, RAPORTIMIT, VERIFIKIMIT DHE AKREDITIMIT (MRVA)
NË LIDHJE ME SHKARKIMET GES**

(Ndryshuar seksioni 1 me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

Neni 8

Monitorimi dhe raportimi i shkarkimeve GES nga operatori i instalimit, nga subjekti i rregulluar dhe verifikimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

1. Operatori i instalimit monitoron shkarkimet GES nga instalimi gjatë një viti kalendarik. Subjekti i rregulluar monitoron shkarkimet GES, që përkojnë me sasinë e lëndëve djegëse të hedhura për konsum gjatë një viti kalendarik. Monitorimi kryhet në përputhje me planin e monitorimit, të miratuar nga AKM-ja.

2. Operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar hartojnë raportin e të dhënave të monitorimit të shkarkimeve të GES-eve të vitit paraardhës dhe e dorëzojnë jo më vonë se muaji janar i çdo viti te verifikuesi i akredituar.

3. Verifikuesi i akredituar verifikon nëse raporti është në përputhje me planin e monitorimit dhe me kriteret e procedurat e monitorimit, harton raportin e verifikimit dhe ia dorëzon atë operatorit të instalimit dhe subjektit të rregulluar, sipas rastit.

4. Operatori i instalimit, brenda muajit mars të çdo viti, dhe subjekti i rregulluar, brenda muajit prill të çdo viti, dorëzojnë pranë AKM-së raportin e të dhënave të monitorimit të shkarkimeve të GES-eve të vitit paraardhës, së bashku me raportin e verifikimit, të hartuar nga verifikuesi i akredituar.

5. Personat fizikë dhe juridikë, që gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare blejnë nga subjekti i rregulluar lëndët djegëse për përdorim në sektorët e përcaktuar në shtojcën II, pjesa D, të këtij ligji, kanë detyrimin të raportojnë menjëherë te subjekti i rregulluar të gjitha informacionet e kërkuara prej tij për destinacionin e këtyre lëndëve djegëse, për t'i mundësuar subjektit të rregulluar përmbushjen e detyrimeve të monitorimit dhe raportimit të shkarkimeve GES, sipas këtij neni. Detyrimi për raportim kryhet në respektim të parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe në respektim të parimit të ruajtjes së sekretit tregtar, sipas legjislacionit për pronësinë industriale. Subjekti i rregulluar ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit për gjokat e marra për mospërmbushjen e detyrimeve të raportimit, sipas këtij neni, në rast se mospërmbushja është pasojë e drejtpërdrejtë e mungesës së raportimit të informacioneve nga personat fizikë dhe juridikë, që furnizohen prej tij me lëndë djegëse, sipas kësaj pike.

6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit dhe, sipas rastit, të ministrit përgjegjës për akreditimin në Republikën e Shqipërisë, miraton rregulloret për kushtet, kriteret dhe procedurat e monitorimit, raportimit dhe verifikimit të shkarkimeve të GES-eve nga operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar dhe i akreditimit të verifikuesve, që përmbajnë:

- a) kushtet, kriteret dhe procedurat për miratimin e përditësimit e planit të monitorimit;
- b) kushtet, kriteret dhe procedurat e hartimit të raportit të të dhënave të monitorimit të shkarkimeve të GES-eve;
- c) kushtet, kriteret dhe procedurat e verifikimit dhe hartimit të raportit të verifikimit nga verifikuesi i akredituar;
- ç) kushtet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të verifikuesit të akredituar;
- d) kushtet e posaçme, procedurën e shqyrtimit dhe vendimmarrjes, procedurën e përditësimit, shfuqizimit dhe tarifën e aplikimit të autorizimit për shkarkimet GES;
- dh) kompetencat e AKM-së në lidhje me raportimin e të dhënave të monitorimit të shkarkimeve të GES-eve nga operatori i instalimit dhe nga subjekti i rregulluar dhe verifikimin nga verifikuesi i akredituar.

Neni 9

Autorizimi për shkarkimet e GES-it nga instalimi dhe subjekti i rregulluar

(Ndryshuar me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

1. Operatori i instalimit pajiset me autorizimin për shkarkimet e GES-eve për ushtrimin e aktiviteteve, të parashikuara në shtojcën II, pjesa A, të këtij ligji, kur çliron GES-et e përcaktuara në këtë shtojcë. Autorizimi për shkarkimet e GES-eve mbulon një ose disa instalime që operohen në të njëjtin vend nga i njëjti operator.

2. Subjekti i rregulluar pajiset me autorizimin për shkarkimet e GES-eve për ushtrimin e aktiviteteve, të parashikuara në shtojcën II, pjesa D, të këtij ligji.

3. Ministri lëshon autorizimin për shkarkimet GES nga operatori i instalimit dhe nga subjekti i rregulluar me paraqitjen prej tyre të planit të monitorimit të shkarkimeve GES, të miratuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

4. Autorizimi për shkarkimet e GES-eve nga operatori i instalimit përmban të paktën elementet, si më poshtë:

- a) emrin dhe adresën e operatorit;
- b) një përshkrim të aktiviteteve dhe shkarkimeve nga instalimi;
- c) planin e monitorimit, të miratuar nga AKM-ja.
- ç) detyrimet për raportimin e shkarkimeve GES nga operatori i instalimit.

5. Autorizimi për shkarkimet e GES-eve nga subjekti i rregulluar përmban të paktën elementet, si më poshtë:

- a) emrin dhe adresën e subjektit të rregulluar;

b) një përshkrim të mënyrës së hedhjes për konsum nga subjekti i rregulluar të lëndëve djegëse për përdorim në sektorët e përcaktuar në shtojcën II, pjesa D, të këtij ligji;

c) një listë të lëndëve djegëse që subjekti i rregulluar hedh për konsum në sektorët e përcaktuar në shtojcën II, pjesa D, të këtij ligji;

ç) planin e monitorimit, të miratuar nga AKM-ja;

d) detyrimet për raportimin e GES-eve nga subjekti i rregulluar.

6. Ministri, me propozimin e strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit, shfuqizon autorizimin e shkarkimeve të GES-eve dhe vendos pezullimin e aktivitetit që shkarkon GES-e në një nga rastet kur:

a) operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar nuk përmbushin detyrimet e monitorimit e të raportimit;

b) operatori i instalimit dhe subjekti i rregulluar nuk përmbushin detyrimin e parashikuar në nenin 10 të këtij ligji.

Neni 10

Ndryshime të instalimit dhe aktivitetit të subjektit të rregulluar

(Ndryshuar me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

1. Operatori i instalimit informon menjëherë AKM-në për çdo ndryshim që planifikon të kryejë në natyrën apo funksionimin e instalimit ose për çdo zgjerim apo reduktim të rëndësishëm të kapacitetit të vet, që mund të kërkojë përditësimin e planit të monitorimit ose të autorizimit të shkarkimeve GES. Konsiderohet ndryshim i rëndësishëm i kapacitetit një ndryshim në funksionim që arrin pragun e kapacitetit prodhues ose sasinë e prodhimit të një instalimi të përfshirë në shtojcën II, pjesa A, të këtij ligji.

2. Subjekti i rregulluar informon menjëherë AKM-në për çdo ndryshim të planifikuar në natyrën e aktivitetit ose të lëndëve djegëse që nxjerr për konsum, të cilat mund të kërkojnë përditësimin e planit të monitorimit ose të autorizimit të shkarkimeve GES.

3. Përditësimi i planit të monitorimit dhe të autorizimit të shkarkimeve GES, në rastet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, kryhet sipas përcaktimeve të akteve nënligjore të parashikuara në shkronjat “a” dhe “d” të pikës 6 të nenit 8 të këtij ligji.

Neni 11

Detyrimet MRVA të operatorit të avionit

(Ndryshuar me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

1. Çdo operator avioni, që sipas legjislacionit në fuqi për transportin ajror konsiderohet transportues ajror shqiptar, që kryen aktivitete aviacioni të përfshira në shtojcën II, pjesa B, të këtij ligji dhe shkarkon GES-e, ka detyrimin e monitorimit dhe të raportimit të shkarkimeve të GES-eve për fluturimet që nisen nga apo arrijnë në një aeroport që ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë ose midis aeroporteve në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Operatori i avionit harton planin e monitorimit të shkarkimeve të GES-eve dhe e paraqet atë për miratim pranë AKM-së.

3. Operatori i avionit monitoron dhe raporton shkarkimet GES gjatë një viti kalendarik nëpërmjet raportit të të dhënave të monitorimit të shkarkimeve GES dhe e dorëzon atë te verifikuesi i akredituar jo më vonë se muaji janar i çdo viti.

4. Verifikuesi i akredituar verifikon nëse raporti është në përputhje me planin e monitorimit dhe me kriteret e procedurat e monitorimit dhe harton raportin e verifikimit.

5. Raporti i të dhënave të monitorimit të shkarkimeve GES të operatorit të avionit, i verifikuar sipas pikës 4 të këtij neni, dorëzohet pranë AKM-së brenda muajit mars të çdo viti.

6. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, dhe, sipas rastit, të ministrit përgjegjës për aviacionin civil dhe për akreditimin në Republikën e Shqipërisë, miraton rregulloren për kushtet, kriteret dhe procedurat e monitorimit, raportimit dhe verifikimit të shkarkimeve të GES-eve nga operatori i avionit dhe akreditimit të verifikuesve, që përmban:

- a) kushtet, kriteret dhe procedurën për miratimin e planit të monitorimit;
- b) kushtet, kriteret dhe procedurat për monitorimin dhe hartimin e raportit të të dhënave të monitorimit të shkarkimeve të GES-eve;
- c) kushtet, kriteret dhe procedurat e verifikimit dhe hartimit të raportit të verifikimit nga verifikuesi i akredituar;
- ç) kushtet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të verifikuesit të akredituar;
- d) kompetencat e AKM-së në lidhje me raportimin e të dhënave të monitorimit të shkarkimeve të GES-eve nga operatori i avionit dhe me verifikimin nga verifikuesi i akredituar.

7. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin dhe të ministrit përgjegjës për transportin, miraton kushtet dhe procedurat e raportimit për efektet në aviacion, të palidhura me shkarkimin e CO₂.

Neni 12

Detyrimet MRVA të shoqërisë së transportit detar

(Ndryshuar me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

1. Çdo shoqëri e transportit detar, për anijet që mbajnë flamurin shqiptar, ka detyrimin e monitorimit dhe të raportimit të shkarkimeve të GES-eve nga anijet e përfshira në shtojcën II, pjesa C, të këtij ligji, që transportojnë mallra apo pasagjerë për qëllime tregtare nga porti i fundit i zbarkimit në një port zbarkimi të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë ose nga një port zbarkimi, i vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, në portin e ardhshëm të zbarkimit, si dhe midis porteve të zbarkimit që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Shoqëria e transportit detar harton planin e monitorimit të shkarkimeve të GES-eve, që verifikohet nga verifikuesi i akredituar dhe miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme Detare.

3. Shoqëria e transportit detar raporton shkarkimet e GES-eve nëpërmjet raportit të të dhënave të monitorimit të shkarkimeve GES, që hartohet nga shoqëria e transportit detar dhe dorëzohet te verifikuesi i akredituar jo më vonë se muaji janar i çdo viti.

4. Verifikuesi i akredituar verifikon raportin e të dhënave të monitorimit të shkarkimeve GES të shoqërisë së transportit detar. Raporti i verifikuar i të dhënave të monitorimit të shkarkimeve GES të shoqërisë së transportit detar dorëzohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme Detare brenda muajit mars të çdo viti.

5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, dhe, sipas rastit, të ministrit përgjegjës për transportin detar dhe për akreditimin në Republikën e Shqipërisë, miraton rregulloret për kushtet, kriteret dhe procedurat e monitorimit, raportimit dhe verifikimit të shkarkimeve të GES-eve nga shoqëria e transportit detar dhe akreditimit të verifikuesve, që përmbajnë:

- a) kushtet, kriteret dhe procedurën për miratimin e planit të monitorimit nga shoqëria e transportit detar dhe për verifikimin nga verifikuesi i akredituar;
- b) kushtet, kriteret e procedurat për monitorimin dhe hartimin e raportit të të dhënave të monitorimit të shkarkimeve GES;
- c) kushtet, kriteret e procedurat e verifikimit dhe hartimit të raportit të verifikimit nga verifikuesi i akredituar;
- ç) kushtet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të verifikuesit të akredituar;
- d) kompetencat e Drejtorisë së Transportit Detar në lidhje me raportimin e të dhënave të monitorimit të shkarkimeve të GES-eve nga shoqëria e transportit detar dhe me verifikimin nga verifikuesi i akredituar.

Neni 12/1
Akreditimi i verifikuesit
(Shtuar me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

1. Çdo person juridik që ushtron në territorin e Republikës së Shqipërisë funksionin e verifikuesit, të parashikuar në këtë ligj, akreditohet sipas ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Çdo person juridik, i regjistruar në territorin e Republikës së Shqipërisë, që ushtron funksionin e verifikuesit sipas këtij ligji, akreditohet nga një organizëm akreditues i huaj vetëm në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 8 të ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

3. Çdo person juridik, i akredituar si verifikues nga një organizëm kombëtar akreditimi i një vendi tjetër, ushtron funksionin e verifikuesit në territorin e Republikës së Shqipërisë kur përmbush kushtet e parashikuara në nenin 13 të ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

4. Kushtet, kriteret, procedurat dhe fushat specifike për akreditimin e verifikuesit përcaktohen në rregulloret e miratuara në zbatim të nenit 8, pika 6, shkronja “ç”, të nenit 11, pika 6, shkronja “ç” dhe të nenit 12, pika 5, shkronja “ç”, të këtij ligji dhe hartohen në përputhje me parimet e ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

SEKSIONI II

Neni 13
Shkarkimet e GES-it nga burimet e lëvizshme
(Shfuqizuar me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

SEKSIONI III
SHKARKIMET E GES-it NGA SEKTORË TË TJERË

Neni 14
Sektori i energjisë

1. Ministritë përgjegjëse për energjinë, ekonominë, zhvillimin urban dhe mjedisin nxitin zbatimin e masave për prodhimin e energjive nga burimet e rinovueshme pa karbon, të masave për ruajtjen e eficiencës së energjisë në të gjithë sektorët ekonomikë, përfshirë performancën e energjisë në ndërtesa, masat për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe zbutjen e ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Masa të tilla rregullohen nga legjislacioni për eficiencën e energjisë, për burimet e energjisë së rinovueshme, si dhe nga legjislacioni tjetër i posaçëm.

2. Zhvillimi i strategjive dhe planeve afatgjata, që integrojnë energjinë dhe ndryshimet klimatike, rregullohet nëpërmjet krijimit të një mekanizmi qeverisës, që miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin.

3. Strategjitë dhe planet afatgjata të energjisë dhe klimës përfshijnë objektiva dhe masa për periodat deri në vitet 2030 dhe 2050, që lidhen me sigurinë energjetike, tregun e brendshëm të energjisë, eficiencën e energjisë, burimet e rinovueshme të energjisë, dekarbonizimin, kërkimin, inovacionin dhe konkurrueshmërinë, si dhe raportimin e progresit të tyre.

4. Plani kombëtar i energjisë dhe klimës për periudhën 2021-2030 miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 14/1

Planet vendore për energjinë, klimën dhe përshtatjen

(Shtuar me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

1. Duke nisur nga viti 2027, njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë planet vendore për energjinë, klimën dhe përshtatjen.

2. Planet vendore për energjinë, klimën dhe përshtatjen hartohen për një periudhë 10-vjeçare dhe janë në përputhje me objektivat kombëtarë, të përcaktuar në strategjitë dhe planet në fushën e energjisë dhe ndryshimeve klimatike.

3. Plani vendor për energjinë, klimën dhe përshtatjen miratohet me vendim të këshillit bashkiak dhe rishikohet çdo 5 vjet ose në çdo kohë që vlerësohet e nevojshme nga njësia e qeverisjes vendore.

4. Para miratimit nga këshilli bashkiak projektplanet vendore për energjinë, klimën dhe përshtatjen konsultohen me ministrinë e linjës sipas fushës së përgjegjësisë, me përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile për vlerësimin e përputhshmërisë së tij me objektivat kombëtarë, të përcaktuar në strategjitë dhe planet në fushën e energjisë dhe ndryshimeve klimatike.

5. Plani vendor për energjinë, klimën dhe përshtatjen dhe raporti i progresit për zbatimin e tij hartohen në përputhje me formatin, kërkesat dhe elementet, të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për mjedisin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energjinë, jo më vonë se 12 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 14/2

Zhvillimi i infrastrukturës së lëndëve djegëse alternative

(Shtuar me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për transportin, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji miraton rregullat për zhvillimin e infrastrukturës së lëndëve djegëse alternative, me qëllim reduktimin e emetimeve të CO₂ dhe ndikimin mjedisor të sektorit të transportit, duke përfshirë:

a) përcaktimin e objektivave kombëtarë, të detyrueshëm për zhvillimin e infrastrukturës së mjaftueshme të lëndëve djegëse alternative për automjetet rrugore, trenat, anijet dhe avionët në gjendje të palëvizshme;

b) përcaktimin e specifikimeve teknike për infrastrukturën e lëndëve djegëse alternative;

c) përcaktimin e specifikimeve dhe kërkesave të përbashkëta teknike për informacionin për përdoruesit e automjeteve, për ofrimin e të dhënave në lidhje me pikat e karikimit dhe shpërndarjes së karburanteve alternative dhe për mënyrat e pagesës;

ç) përcaktimin e elementeve dhe përmbajtjes së raportit vjetor për zhvillimin e infrastrukturës së lëndëve djegëse alternative.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për transportin, brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji miraton dokumentin strategjik për politikën kombëtare për zhvillimin e tregut, në lidhje me lëndët djegëse alternative në sektorin e transportit dhe vendosjen e infrastrukturës përkatëse.

Neni 14/3

Shkarkimet nga automjetet e reja

(Shtuar me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

1. Automjetet e reja për pasagjerë, automjetet e reja të lehta tregtare dhe automjetet e rënda vendosen në treg vetëm nëse janë në përputhje me kërkesat e performancës së emetimeve të CO₂, të specifikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, sipas pikës 2 të këtij neni.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për transportin, miraton rregullat e detajuara të performancës së shkarkimeve të CO₂ nga automjetet e reja për pasagjerë, automjetet e reja të lehta tregtare dhe automjetet e rënda, të cilat përfshijnë:

a) monitorimin dhe raportimin e të dhënave për regjistrimin e automjeteve të reja për pasagjerë për vlerësimin e reduktimit të shkarkimeve të CO₂ nga automjetet e lehta tregtare;

b) monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të CO₂ nga automjetet e reja për pasagjerë dhe nga automjetet e reja të lehta tregtare.

3. Automjetet e reja për pasagjerë dhe automjetet e reja të lehta tregtare mund të shiten ose të jepen me qira vetëm nëse janë të shoqëruara me informacionin e duhur për konsumatorin për ekonominë e karburantit dhe emetimet e CO₂.

4. Masat për sigurimin e informacionit për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ gjatë marketingut të automjeteve të reja, sipas pikës 3 të këtij neni, miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për transportin.

SEKSIONI IV

(Shfuqizuar titulli i seksionit me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

Neni 15

Shkarkimet nga lëndët djegëse

(Shfuqizuar me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

Neni 16

Substancat ozonholluese (ODS)

1. Masat për mbrojtjen e shtresës së ozonit përfshijnë nxjerrjen jashtë përdorimit të substancave ozonholluese dhe zëvendësimin e tyre nga substanca dhe produkte alternative, që janë miqësore ndaj shtresës së ozonit.

2. Për prodhimin, importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e substancave ozonholluese, si dhe për importin, eksportin, hedhjen në treg dhe përdorimin e produkteve të pajisjeve që përmbajnë këto substanca zbatohen rregullat e miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave në zbatim të ligjit nr. 26/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”.

Neni 17

Gazet e fluorinuara

1. Gazet e fluorinuara janë përdorur si substanca alternative për të zëvendësuar substancat ozonholluese, por ato janë gaze me efekt serrë të fuqishme. Masat për parandalimin, kufizimin, përdorimin, rikuperimin dhe shkatërrimin e gazeve serrë të fluorinuara, si edhe të kushteve për hedhjen në treg të produkteve dhe pajisjeve specifike që i përmbajnë ose funksionimi i të cilave bazohet në gazet serrë të fluorinuara, çojnë në reduktimin e gazeve me efekt serrë.

2. Masat për reduktimin dhe stabilizimin e shkarkimeve të gazeve serrë të fluorinuara miratohen me ligj të veçantë.

SEKSIONI V

PËRTHITHJA, KAPJA DHE DEPOZITIMI I SHKARKIMEVE TË GES-it

Neni 18

Përdorimi i tokës, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyjet (LULUCF)

1. Ministria përgjegjëse për mjedisin, ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe/ose bashkitë projektojnë dhe zhvillojnë politika dhe masa për zbutjen e ndryshimeve klimatike në fushën e pyjeve e të bujqësisë, duke synuar reduktimin e shkarkimeve dhe përthithjen e karbonit nga sektorët e bujqësisë, të pyjeve, përdorimeve të tjera të tokës dhe ruajtjes së ekosistemeve. Në mënyrë të veçantë, bazuar edhe në të dhënat e sistemit të monitorimit të pyjeve, ato angazhohen për:

- a) luftën kundër shpyllëzimeve dhe degradimit të ekosistemeve pyjore për t'i rikthyer ato në gjendjen e mëparshme, për të zgjeruar sipërfaqet e tokës me bimësi dhe me përmbajtje karboni organik, duke zbatuar praktika të menaxhimit të qëndrueshëm në zonat bujqësore;
- b) ruajtjen, zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe shtimin e rezervave të karbonit në pyje;
- c) zhvillimin e programeve për menaxhimin e qëndrueshëm dhe restaurimin e ekosistemeve pyjore, ligatinore e bregdetare-detare;
- ç) përfshirjen e sa më shumë ekosistemeve në planet e ruajtjes (*conservation plans*);
- d) forcimin e luftës kundër zjarreve në pyje;
- dh) projektimin dhe sigurimin e iniciativave ekonomike për përthithjen e karbonit dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura.

2. Bashkitë informojnë çdo vit ministrinë për shpyllëzimet dhe degradimin e pyjeve, që kanë ndodhur në territorin administrativ nën juridiksionin e tyre.

3. Ministria regjistron të dhënat për zonat që kanë pësuar shpyllëzim dhe degradim për shkak të zgjerimit të tokave bujqësore, të kthimit në kullota, të zhvillimit infrastrukturor, të prerjeve të paligjshme dhe zjarreve.

4. Rregullat e përllogaritjes së shkarkimeve të GES-it dhe të përthithjes së tyre, që rezultojnë nga aktivitetet që lidhen me përdorimin e tokës, ndryshimin e përdorimit të tokës e pyjeve, si dhe për informacione të tjera që lidhen me këto aktivitete, miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin dhe të ministrit përgjegjës për bujqësinë.

Neni 19

Kapja dhe depozitimi gjeologjik i dyoksidit të karbonit

1. Operatori i një instalimi të listuar në shtojcën II-A të këtij ligji, që shkarkon CO₂, mund të zgjedhë t'i zbusë këto shkarkime nëpërmjet mënyrave të ndryshme të kapjes dhe depozitimit të tij, si, për shembull, në formacione gjeologjike nën tokë ose përmes veprimeve të tjera që çojnë në këtë rezultat, sipas kërkesave të përcaktuara në vendimin e parashikuar në pikën 2 të këtij neni.

2. Rregullat e kapjes dhe të depozitimit gjeologjik të dyoksidit të karbonit apo në mënyra të tjera miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për minierat dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin.

SEKSIONI VI

MATJA, RAPORTIMI DHE VERIFIKIMI I SHKARKIMEVE TË GES-it

Neni 20

Matja, raportimi dhe verifikimi (MRV)

1. MRV-ja nënkupton matjen apo vlerësimin e bërë në Republikën e Shqipërisë, raportimin si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, verifikimin (sigurimin dhe kontrollin e cilësisë)

QA/QC në nivel kombëtar, si dhe mbikëqyrjen ndërkombëtare të shkarkimeve/përthithjes ose të dhënave të tjera, që matin performancën, të përcaktuara në:

- a) Raportin Kombëtar të Inventarit të GES-it;
- b) komunikimet kombëtare, raportet e përditësuara dyvjeçare, raportin e NDC-së;
- c) raportet e monitorimit të shkarkimeve të GES-it nga operatorët që kanë këtë detyrim;
- ç) analizën e efekteve të zbatimit të dokumenteve strategjike për ndryshimet klimatike;
- d) projeksionet e emetimeve antropogjene të gazeve serrë dhe përthithjen e tyre;
- dh) investimet dhe mbështetjen financiare për ndryshimet klimatike.

2. Sistemi MRV ngrihet për të rritur transparencën për përpjekjet që bëhen për zbutjen e ndryshimeve klimatike. MRV-ja synon:

a) të masë si përpjekjet për zbutjen e ndryshimeve klimatike, ashtu edhe ndikimin e zbatimit të masave të përshtatshme kombëtare, nivelin e shkarkimeve të GES-it dhe tërheqjen e tyre nga përthithësit, reduktimin e shkarkimeve;

b) të raportojë informacionin e matur në mënyrë transparente dhe të standardizuar nëpërmjet komunikimeve kombëtare, raporteve të përditësuara dyvjeçare (BUR), raporteve të zbatimit të NDC-së, siç parashikohet në nenin 22;

c) të verifikojë e të vlerësojë saktësinë, plotësinë, konsistencën dhe besueshmërinë e informacionit të raportuar nëpërmjet një procesi të pavarur.

3. MRV-ja në Republikën e Shqipërisë do të funksionojë si një sistem me qasje nga poshtë-lart, me të dhëna që monitorohen fillimisht nga operatorët, operatorët e avionëve dhe të anijeve, që janë subjekt i këtij ligji, përfshirë institucionet e varësisë, sipas rastit, të cilat u raportohen ministrive përkatëse të linjës dhe AKM-së, siç përcaktohet në aktet nënligjore që burojnë nga ky ligj. Sistemi MRV do të trajtojë njëkohësisht edhe kërkesat ndërkombëtare.

Neni 21

Monitorimi, raportimi i shkarkimeve të GES-it dhe informacioneve të tjera, që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregulloren për monitorimin, raportimin e shkarkimeve të GES-it dhe të informacioneve të tjera, që lidhen me ndryshimet klimatike në nivel kombëtar.

2. Vendimi, i parashikuar në pikën 1 të këtij neni, krijon:

a) Sistemin Kombëtar të Inventarit të GES-it, duke përcaktuar procedurat kombëtare për grumbullimin, përpunimin, raportimin, verifikimin dhe arkivimin e të dhënave e të informacionit të kërkuar, i cili duhet të jetë funksional, mbi baza të qëndrueshme e të vazhdueshme, si dhe përcakton organet kompetente;

b) Sistemin e Monitorimit dhe të Vlerësimit (M&V) të masave kombëtare për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike. Nëpërmjet M&V-së synohet ndjekja e progresit në zbatimin e politikave, të planeve adaptuese, ndërhyrjeve e investimeve të përshtatjes dhe/ose sesi këto ndërhyrje po reduktojnë vulnerabilitetin, duke përmirësuar kapacitetin adaptues dhe duke mbështetur mirëqenien e përgjithshme të popullsisë së prekur nga ndikimet e ndryshimeve klimatike.

Neni 22

Raportimet kundrejt Konventës

1. Format kryesore të raportimit të Republikës së Shqipërisë në Konventë janë:

- a) komunikimet kombëtare;
- b) raportet e përditësimit dyvjeçar (BUR);
- c) raporti i zbatimit të NDC-së;

- ç) raporti i inventarit kombëtar të shkarkimeve të GES-it.
2. Kërkesat për përgatitjen e tyre përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave sipas nenit 21, pika 1, të këtij ligji.

KREU IV AUTORITETET KOMPETENTE

Neni 23 **Kuadri institucional dhe koordinimi ndërministror**

1. Për të lehtësuar koordinimin efektiv midis të gjithë aktorëve të sektorit publik e privat, për të siguruar një monitorim, raportim e verifikim (MRV) me cilësi të lartë në vazhdimësi dhe në kohë të raportimeve kundrejt Konventës dhe për të trajtuar çdo masë tjetër për ndryshimet klimatike bëhen rregullimet institucionale si më poshtë:

a) ministria është pika qendrore kombëtare e Konventës dhe institucioni përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm dhe menaxhimin e sistemit MRV, përfshirë koordinimin e procesit të përgatitjes së komunikimit kombëtar, të raporteve të përditësimit dyvjeçar (BUR) dhe raportit të zbatimit të NDC-së;

b) AKM-ja është autoriteti kompetent kombëtar për të gjitha aktivitetet që lidhen me ngritjen dhe mbajtjen e Sistemit Kombëtar të Inventarit, si pjesë e sistemit të informacionit mjedisor;

c) ministrinë e linjës, kompetencat e të cilave bien në fushat e përgjegjësisë shtetërore që ndikojnë apo ndikohen nga ndryshimet klimatike, sipas rastit, grumbullojnë dhe mbajnë të dhëna për aktivitete, tregues specifikë/tematikë të grupuar dhe informacion që lidhet me klimën e i ofrojnë ministrisë kontributin e tyre me shkrim në përputhje me kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave të parashikuar në nenin 21 të këtij ligji. Ato marrin pjesë në përgatitjen dhe deri në finalizimin e miratimit të të gjitha dokumenteve, si dhe në raportimet, sipas nenit 22 të këtij ligji, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

ç) INSTAT-i ka detyrimin t'i ofrojë ministrisë të gjitha të dhënat social-ekonomike të popullsisë dhe të tjera që lidhen me to;

d) operatorët, që janë subjekt i këtij ligji, dhe institucionet publike, aktivitetet e të cilave bien në fushat e përgjegjësisë shtetërore që jepen në pikën 2 të këtij neni, grumbullojnë, organizojnë dhe mbajnë, sipas rastit, të dhënat e tyre për klimën, bashkë me raportet përkatëse, dhe i vënë në dispozicion të ministrisë përkatëse;

dh) ministrinë e tjera të linjës dhe institucionet publike/private, aktivitetet e të cilave nuk bien në fushat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, kontribuojnë, sipas rastit, me kërkesën e ministrisë;

e) IGJEUM-i, institutet e tjera kërkimore-shkencore, si dhe universitetet publike ose private, që kryejnë matje, kërkime apo studime për klimën, i vënë këto në dispozicion të ministrisë/AKM-së, duke iu njohur e drejta e autorit sipas legjislacionit në fuqi;

ë) bashkitë, për territorin nën juridiksionin e vet, grumbullojnë, organizojnë dhe mbajnë të dhënat e tyre për klimën së bashku me raportet për masat e marra ose të planifikuara për zbatimin dhe adaptimin e i vendosin këto në dispozicion të ministrisë;

f) ministria, bazuar në dokumentet më të fundit të promovuara nga Konventa dhe në rrethanat specifike social-ekonomike të vendit, harton metodologjitë kombëtare për përgatitjen e komunikimit kombëtar të BUR-it, NDC-së dhe metodologji të tjera, që nevojiten për zbatimin e këtij ligji, me mbështetjen teknike dhe shkencore të institucioneve që parashikohen në këtë nen. Metodologjitë miratohen me udhëzim të ministrit.

2. Fushat e përgjegjësisë shtetërore, të parashikuara në shkronjat “c” dhe “d” të pikës 1 të këtij neni, përfshijnë: industrinë energjetike, industrinë prodhuese, të ndërtimit, të lëndëve djegëse, të minierave dhe gjeologjisë, të pyjeve, biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura, të

bujqësisë e blegtorisë, menaxhimit të ujit, mbetjeve, shëndetit, transportit e infrastrukturës (përfshirë atë rrugore e hekurudhore, portet dhe aeroportet, tubacionet, digat, ujin dhe ujërat e zeza), planifikimin urban, menaxhimin e tokës, turizmin, arsimin, emergjencat civile dhe në menaxhimin e fatkeqësive.

3. Me qëllim bashkërendimin e detyrave të ministrive dhe institucioneve publike/private, në përputhje me detyrimet e vendit ndaj Konventës dhe Marrëveshjes së Parisit, ngrihet dhe funksionon grupi ndërministror i punës (Komiteti Kombëtar për Ndryshimet Klimatike) për ndryshimet klimatike, me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit.

Neni 24

Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Republika e Shqipërisë merr pjesë në skemën ndërkombëtare të tregtimit të shkarkimeve të GES-it, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, që përshtat mekanizmat ndërkombëtarë të ndryshimeve klimatike dhe udhëzuesit ndërkombëtarë që zbatohen për këtë qëllim.

2. Republika e Shqipërisë merr pjesë në projektet e mekanizmit të zhvillimit të pastër, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, që përshtat mekanizmat ndërkombëtarë të ndryshimeve klimatike dhe udhëzuesit ndërkombëtarë që zbatohen për këtë qëllim.

3. Kontributi Kombëtar i Përcaktuar, sipas nenit 7 të këtij ligji, i komunikohet Konventës deri në fund të vitit të pestë kalendarik pas komunikimit të parë.

4. Dokumenti Strategjik, Plani Kombëtar për Zbutjen e Gazeve me Efekt Serrë (NMP) dhe Plani Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP) i komunikohen Konventës në afatet e përcaktuara në vendimet për zbatimin e Marrëveshjes së Parisit.

5. Republika e Shqipërisë përfaqësohet në negociatat ndërkombëtare në kuadër të Konventës dhe integritetit evropian nga ministria, në cilësinë e *focal point* të Konventës dhe institucionit përgjegjës për fushën e ndryshimeve klimatike, në bashkëpunim me ministritë e linjës.

6. Ministritë e linjës, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, bashkëpunojnë me komunitetin ndërkombëtar për zbatimin e Konventës dhe inkurajojnë iniciativat dypalëshe e shumëpalëshe, që synojnë shkëmbimin dhe ndarjen e informacionit për eksperiencat që lidhen me hartimin e politikave e të praktikave të mira ekzistuese, që kontribuojnë për zhvillimin e ekonomive me pak karbon dhe për të mbështetur e përhapur masat që lidhen me klimën.

KREU V

NGRITJA E KAPACITETEVE, EDUKIMI, TRAJNIMI, NDËRGJEGJËSIMI DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT

Neni 25

Ngritja e kapaciteteve

Ministritë e linjës bashkëpunojnë në mënyrë efektive, eficiente, të integruar e të programuar për ngritjen e kapaciteteve të tyre, të bashkive, të institucioneve financiare, të sektorit privat e të organizatave jofitimprurëse (OJF-ve) për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

Neni 26

Edukimi dhe trajnimi

1. Ministria bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për arsimin për hartimin dhe zbatimin e programeve në fushën e mjedisit e të ndryshimeve klimatike për të gjitha nivelet e arsimit.

2. Ministria bashkëpunon sa herë që i kërkohet nga ministria përgjegjëse për arsimin lidhur me përmbajtjen e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera didaktike dhe nxit pjesëmarrjen e institucioneve arsimore të të gjitha niveleve në iniciativa për kërkime shkencore, edukim dhe trajnim në fushën e mjedisit e të ndryshimeve klimatike në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

3. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe ministria përgjegjëse për punën bashkëpunojnë për hartimin dhe zbatimin e programeve të edukimit në vazhdim dhe trajnimet në fushën e mjedisit e të ndryshimeve klimatike.

Neni 27

Informacioni dhe ndërgjegjësimi publik

1. Ministritë e linjës, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, brenda fushave të kompetencave shtetërore përkatëse ndërmarrin fushata informimi për të sensibilizuar e ndërgjegjësuar popullatën për efektet negative të ndryshimeve klimatike, për masat konkrete që mund të marrin për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, në zbatim të kërkesave të këtij ligji dhe objektivave strategjikë të vendit në këtë fushë.

2. Fushatat e ndërgjegjësimit i kushtojnë vëmendje të veçantë rolit dhe përfshirjes së grave në përpjekjet për përshtatjen dhe zbutjen ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe grupeve në nevojë apo komuniteteve të prekura.

3. Ministria harton udhëzuesin për integrimin e çështjeve gjinore në programet e zbatjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.

Neni 28

Pjesëmarrja publike

1. Ministritë e linjës, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, gjatë përgatitjes apo përditësimit të legjislacionit dhe strategjive të tyre në lidhje me klimën, garantojnë pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të interesuar, përfshirë njësitë e qeverisjes vendore, sektorin privat dhe publikun, sipas përcaktimeve të Konventës së Aarhusit dhe legjislacionit përkatës kombëtar.

2. E drejta e publikut për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes për mjedisin përcaktohet në akte ligjore të posaçme.

KREU VI

INVESTIMET DHE FINANCIMET E GJELBËRTA

Neni 29

Nxitja e investimeve miqësore ndaj mjedisit/klimës

1. Ministritë e linjës dhe bashkitë, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, hartojnë politika që nxisin sektorin publik dhe privat për investime të konsiderueshme që shkarkojnë pak GES, janë transparente, kanë rezultate të parashikueshme, janë pak të ndikueshme nga ndryshimet klimatike dhe inkurajojnë ndërmarrjet, institucionet, grupet sociale dhe individët për të ndjekur dhe për t'iu përshtatur progresit dhe inovacionit teknologjik, zbatimit të rezultateve të shkencës e teknologjisë, zhvillimit të arsimit dhe industrisë, në zbatim të kërkesave të këtij ligji.

2. Ministritë e linjës dhe bashkitë, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, përditësojnë politikat/dokumentet kombëtare, në mënyrë që të nxisin investimet për projekte miqësore ndaj klimës, mbështesin kërkimin shkencor dhe nxisin praktikën më të mirë në fushat prioritare, si më poshtë:

a) në fushën e prodhimit të energjisë: investimet për energjitë e rinovueshme, shpërndarjen, menaxhimin e shpërndarjes, ruajtjen e energjisë, produktet/teknologjitë që mbështesin sistemet energjetike inteligjente, qendrat e të dhënave për përdorimin e energjive të rinovueshme;

b) në fushën e eficiencës së energjisë: investimet për ndërtesat tregtare të gjelbërta, kreditë për banesa të gjelbërta, teknologjitë dhe produktet me përdorim eficient të energjisë, përmirësimet e teknologjisë;

c) në fushën e transportit: investimet për transportin publik, infrastrukturën për automjete elektrike, skema të qiradhënies së biçikletave, automjete me shkarkime të pakta;

ç) në fushën e ujërave: investimet për përshtatjen ndaj ujërave të shirave/stuhive, investimet për grumbullimin e ujërave të shirave, të trajtimit dhe riciklimit të ujërave, përshtatja e rrugëve ujore; riciklimi i ujërave të përdorura në fermat blegtorale të rritjes dhe mbarështimit të gjedhëve, të imtave dele/dhi, shpendarisë, rritjes dhe mbarështimit të derrave, fabrikat e regjjes dhe përpunimit të lëkurëve;

d) në fushën e menaxhimit të mbetjeve: investimet për kapjen e metanit, shndërrimin e mbetjeve në lëndë djegëse;

dh) në fushën e përdorimit të tokës: investimet për pyjet dhe zinxhirët e furnizimit të qëndrueshëm, bujqësia e qëndrueshme;

e) në fushën e përshtatjes së infrastrukturës: investimet për përshtatjen e infrastrukturës ndaj rritjes së temperaturave, rizhvillimin e porteve për të trajtuar rritjen e nivelit të detit, mbrojtjen nga stuhitë;

ë) në fushën e mbrojtjes së natyrës: praktikat e menaxhimit të përshtatjes për zonat e mbrojtura, vlerësimin e rëndësisë së biodiversitetit në lidhje me kapacitetet e ekosistemeve për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike, duke siguruar, në të njëjtën kohë, nivelin e shërbimeve të ekosistemeve, nga të cilat varet shoqëria njerëzore, vlerësimi dhe analiza e ndikimeve të adaptimit të ndryshimeve klimatike dhe masave zbutëse në biodiversitet.

Neni 30

Transferimi i teknologjive/teknologjitë me pak karbon

1. Ministritë e linjës, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, dhe autoritetet e tjera kompetente, të përcaktuara në kreun IV të këtij ligji, në fushat e tyre të përgjegjësisë shtetërore:

a) dekurajojnë transferimin e teknologjive të vjetra, inkurajojnë kërkime në shkencë e teknologji, si dhe zhvillimin, transferimin dhe përdorimin e teknologjive, pajisjeve dhe proceseve për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe përshtatjen, me qëllim uljen e vulnerabilitetit ndaj ndryshimeve klimatike, për përmirësimin e performancës mjedisore dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm;

b) inkurajojnë vendosjen e bashkëpunimit ndërkombëtar, që synon dhënien e ndihmës për transferimin e njohurive teknike, të aftësive teknike e menaxheriale për zhvillimin e institucioneve dhe rrjeteve të nevojshme, për sigurimin e pjesëmarrjes së aktorëve privatë dhe publikë;

c) përshtatin standardet e duhura dhe nxisin marrëveshjet vullnetare ndërmjet trupave dhe organizatave që përfaqësojnë interesa të caktuara, grupe operatorësh e operatorë të veçantë dhe autoritetet përkatëse për të nxitur zhvillimin e teknologjive eficiente.

2. Projektet për kërkim, zhvillim, novacion dhe transferim të teknologjive, sipas pikës 1 të këtij neni, do të jenë në përputhje me prioritetet dhe nevojat e përcaktuara në strategjitë sektoriale të zhvillimit me karbon të ulët, në planin kombëtar për zbutje të GES-it dhe programet për mjedisin e klimën.

Neni 31

Përfshirja e sektorit privat

Për të arritur objektivat e reduktimit të shkarkimeve kombëtare të GES-it, të përcaktuara në NDC, ministritë e linjës, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, nxisin përfshirjen e sektorit privat dhe partneritetin me të, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon partneritetin publik privat.

Neni 32

Mekanizmat financiarë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për ndryshimet klimatike

1. Të gjitha autoritetet kompetente, sipas pikës 2 të nenit 23 të këtij ligji, nxisin zhvillimin e projekteve e të programeve lokale dhe kombëtare, pjesëmarrjen në projekte, programe rajonale dhe ndërkombëtare, që synojnë arritjen e objektivave për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

2. Ministria përgjegjëse për koordinimin e ndihmës së huaj bashkëpunon me ministrinë dhe ministritë e linjës për të siguruar integrimin e çështjeve të klimës edhe në projekte e programe të tjera, në mënyrë që vendi të përfitojë nga fondet ndërkombëtare respektive.

3. Fondi i mjedisit, sipas ligjit për mbrojtjen e mjedisit, përdoret për të mbështetur zbatimin e masave për zbutje dhe përshtatje, sipas kërkesave të këtij ligji, dhe për të mbështetur prioritetet e dokumenteve politike, kombëtare për ndryshimet klimatike.

4. Mekanizmi i Zhvillimit të Pastër (CDM) i Protokollit të Kiotos mund të përdoret si një kuadër për zbatimin e aktiviteteve të projekteve që synojnë të zbutin shkarkimet antropogjene në Republikën e Shqipërisë.

5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton vendimin për krijimin e Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar të Mekanizmit të Zhvillimit të Pastër (CDM) në kuadër të Protokollit të Kiotos.

Neni 33

Fondi i Gjelbër për Klimën (GCF)

(Ndryshuar pika 4, shtuar pika 5 me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

1. Fondi i Gjelbër për Klimën (GCF) është një mekanizëm financimi ndërkombëtar, i krijuar nga Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike për të mbështetur investimet për reduktimin e gazeve me efekt serrë dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, si një kontribut i rëndësishëm dhe ambicioz për të luftuar ndryshimet klimatike.

2. Qasja ndaj Fondit të Gjelbër së Klimës sigurohet nëpërmjet Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar (NDA), si institucioni ndërmjetës midis Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Gjelbër për Klimën.

3. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar udhëheq procesin e përgatitjes së programit kombëtar për ndryshimet klimatike dhe i komunikon Fondit të Gjelbër për Klimën prioritetet kombëtare për të mundësuar financimin e projekteve për reduktimin e gazeve me efekt serrë dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

4. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar (NDA) është ministri ose zëvendësministri i deleguar me urdhër të ministrit.

5. Ministria, institucionet e varësisë, sipas rastit, dhe ministritë e sektorëve të ndikuar nga ndryshimet klimatike mbështesin me ekspertizë teknike Autoritetin Kombëtar të Përcaktuar (NDA) gjatë ushtrimit të funksioneve të tij. Ministri përcakton me udhëzim procedurën dhe formën e organizimit e të bashkërendimit të punës midis NDA-së dhe organeve mbështetëse.

KREU VII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 34

Kundërvajtjet

(Ndryshuar togfjalësh në pikat 2, 3 dhe 5 me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024; ndryshuar shkronjat "a", "b" dhe "c", shtuar shkronja "ç" në pikën 1 me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

1. Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) zhvillimi i aktiviteteve nga operatori i instalimit dhe nga subjekti i rregulluar, pa u pajisur me autorizimin për shkarkimet e GES-eve, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 2 000 000 (dy milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë, që rritet në masën 2 për qind të vlerës së gjobës çdo ditë deri në korrigjimin e mospërmbushjes;

b) zhvillimi i aktiviteteve nga operatori i avionit dhe shoqëria e transportit detar, pa planin e monitorimit të miratuar nga institucionet kompetente, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në nenet 11 dhe 12 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 2 000 000 (dy milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë, që rritet në masën 2 për qind të vlerës së gjobës çdo ditë deri në korrigjimin e mospërmbushjes;

c) mospërmbushja e detyrimeve të raportimit të shkarkimeve GES nga operatori i instalimit, subjekti i rregulluar, operatori i avionit dhe shoqëria e transportit detar, në kundërshtim me kërkesat e neneve 8, 11 dhe 12 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 2 000 000 (dy milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë, që rritet në masën 2 për qind të vlerës së gjobës çdo ditë deri në korrigjimin e mospërmbushjes.

ç) mosnjoftimi në AKM nga operatori i instalimit dhe nga subjekti i rregulluar i ndryshimeve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 10 të këtij ligji dënohet me gjobë në vlerën nga 2 000 000 (dy milionë) deri në 4 000 000 (katër milionë) lekë, që rritet në masën 2 për qind të vlerës së gjobës çdo ditë deri në korrigjimin e mospërmbushjes.

2. Të drejtën e gjobës për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë nen e ka struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit.

3. Subjekti ndaj të cilit vendoset masa administrative ka të drejtën e ankimit në përputhje me ligjin për inspektimin .

4. Gjopa paguhet brenda një periudhe prej 10 ditësh kalendarike nga njoftimi i saj, përveçse kur vendimi për vënien e saj është pezulluar sipas legjislacionit në fuqi.

5. Ministri, me propozimin e strukturës përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit, në rastet kur gjopa nuk është paguar brenda afatit të përcaktuar, vendos pezullimin e lejes përkatëse të mjedisit për të gjithë veprimtarinë apo pjesë të saj deri në pagesën e gjobës, dhe vendimi i pezullimit publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

6. Subjekti ndaj të cilit merret masa e pezullimit ka të drejtën e ankimit sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 35

Menaxhimi i informacionit

(Shtuar pika 2/1, ndryshuar pika 5 me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

1. AKM-ja publikon listën e instalimeve të shtojcës II-A, që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Ministria përgjegjëse për transportin publikon listën e operatorëve të avionëve/operatorëve të lundrimit, të licencuar prej saj gjatë vitit të mëparshëm kalendarik dhe

që kanë kryer aktivitete aviacioni/lundrimi që mbulohen nga ky ligj, brenda datës 1 shkurt të çdo viti në vazhdim dhe e përditëson këtë listë.

2/1. Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Detar i përcjell AKM-së vendimet, planin e monitorimit dhe raportin e të dhënave të monitorimit të shkarkimeve të GES-eve të shoqërisë së transportit detar.

3. AKM-ja mban dhe përditëson regjistrin kombëtar të të dhënave, i cili përmban:

- a) listën e operatorëve sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni;
- b) vendimet dhe raportet për rezultatet e monitorimit, raportimet e verifikimit të shkarkimeve të GES-it nga operatorët që e kanë këtë detyrim;
- c) Raportin Kombëtar të Inventarit të GES-it;
- ç) komunikimet kombëtare, raportet e përditësuara dyvjeçare, raportin e NDC-së;
- d) analizën e efekteve të zbatimit të dokumenteve strategjike për ndryshimet klimatike;
- dh) projeksionet e emetimeve antropogjene të gazeve serrë dhe përthithjen e tyre;
- e) investimet dhe mbështetjen financiare për ndryshimet klimatike.

4. Regjistri kombëtar i të dhënave është pjesë e sistemit të informacionit mjedisor.

5. Nivelet e shkarkimeve vjetore GES nga subjektet që depozitojnë pranë autoriteteve kompetente raportet e të dhënave të monitorimit të GES-eve, në përputhje me nenet 8, 11 dhe 12 të këtij ligji, bëhen menjëherë të disponueshme për publikun dhe përditësohen rregullisht, duke siguruar akses për të gjithë, në përputhje me vendimin nr. 16, datë 4.1.2012, të Këshillit të Ministrave “Për të drejtën e publikut për të pasur informacion mjedisor”.

6. Pjesa e të dhënave të parashikuara në këtë nen, që sipas legjislacionit në fuqi klasifikohen si sekret shtetëror apo janë subjekt i legjislacionit në fuqi për të dhënat personale, profesionale e tregtare, trajtohen sipas atij legjislacioni.

Neni 36

Raportimi

(Ndryshuar me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

1. AKM-ja përgatit raportin për zbatimin e kërkesave për monitorimin, raportimin, verifikimin e shkarkimeve të GES-eve, sipas kërkesave të këtij ligji dhe akteve nënligjore të tij, çdo vit pas fillimit të efekteve të detyrimeve të operatorëve, sipas parashikimeve të nenit 38/1 të këtij ligji, dhe ia vendos në dispozicion ministrisë përgjegjëse për mjedisin.

2. Format i dhe përmbajtja e raportit të parashikuar në këtë nen miratohet me urdhër të ministrit.

Neni 37

Aktet nënligjore

(Ndryshuar pikat 1, 2, shfuqizuar pika 3 me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, pikat 6 e 7; 7, pika 5; 8, pika 6; 11, pikat 6 e 7; 12, pika 5; 14, pikat 2 e 4; 14/1, pika 5; 14/2; 14/3, pikat 2 e 4; 18, pika 4; 19, pika 2; 21, pika 1; 22, pika 2, dhe 32, pika 5.

2. Ngarkohet ministri të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 7, pika 4; 23, pika 1, shkronja “f”; 27, pika 3, dhe nenit 36, pika 2.

3. Shfuqizuar.

Neni 38

Akte nënligjore që mbeten në fuqi

1. Vendimi nr. 865, datë 10.12.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për reduktimin dhe stabilizimin e shkarkimeve të gazeve serrë të fluorinuara” do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të nenit 17 të këtij ligji.

2. Vendimi nr. 762, datë 16.9.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e dokumentit për përcaktimin e kontributit kombëtar të pikësnyuar kundrejt arritjes së objektivit të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike” do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të nenit 23 të këtij ligji.

3. Vendimi nr. 1553, datë 26.11.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar të Mekanizmit të Zhvillimit të Pastër, në kuadër të zbatimit të angazhimeve të Protokollit të Kiotos” do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të pikës 5 të nenit 32 të këtij ligji.

4. Urdhri nr. 155, datë 25.4.2014, i Kryeministrit, “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërmnistror të punës në fushën e ndryshimeve klimatike” do të vazhdojë të ketë efekt dhe do të referohet si në zbatim të këtij ligji.

Neni 38/1

Fillimi i efekteve

(Shtuar me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

1. Detyrimi i operatorit të instalimit për pajisjen me autorizimin për shkarkimet GES, sipas pikave 1 dhe 3 të nenit 9 të këtij ligji, i fillon efektet menjëherë pas miratimit të akteve nënligjore të përcaktuara në pikën 1 të nenit 37 të këtij ligji. Në çdo rast, autorizimet e shkarkimeve GES për të gjithë operatorët e instalimeve, subjekt i këtij ligji, do të lëshohen jo më vonë se data 31 dhjetor 2026.

2. Detyrimi i operatorit të avionit për hartimin e planit të monitorimit për shkarkimet GES dhe për paraqitjen e tij për miratim nga AKM-ja, sipas pikës 2 të nenit 11 të këtij ligji, fillon menjëherë pas miratimit të akteve nënligjore të përcaktuara në pikën 1 të nenit 37 të këtij ligji. Në çdo rast, procedura e miratimit të planit të monitorimit për të gjithë operatorët e avionit, subjekt i këtij ligji, do të kryhet jo më vonë se data 31 dhjetor 2026.

3. Detyrimi i subjektit të rregulluar për pajisjen me autorizimin për shkarkimet GES, sipas pikave 2 dhe 3 të nenit 9 të këtij ligji, fillon menjëherë pas miratimit të akteve nënligjore, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 37 të këtij ligji. Në çdo rast, autorizimet e shkarkimeve GES për të gjitha subjektet e rregulluara, që i nënshtrohen këtij ligji, do të lëshohen jo më vonë se data 31 dhjetor 2027.

4. Detyrimi i shoqërisë së transportit detar për hartimin e planit të monitorimit për shkarkimet GES dhe për paraqitjen e tij për miratim nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, sipas pikës 2 të nenit 12 të këtij ligji, fillon menjëherë pas miratimit të akteve nënligjore të përcaktuara në pikën 1 të nenit 37 të këtij ligji. Në çdo rast, procedura e miratimit të planit të monitorimit për të gjitha shoqëritë e transportit detar, subjekt i këtij ligji, do të kryhet jo më vonë se data 31 dhjetor 2027.

5. Detyrimet e operatorit të instalimit dhe operatorit të avionit për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të GES-eve, sipas pikave 1 deri 4 të nenit 8 dhe të pikave 3 deri 5 të nenit 11 të këtij ligji, fillojnë menjëherë pas pajisjes me autorizimin për shkarkimet GES dhe, në çdo rast, jo më vonë se data 1 janar 2027.

6. Detyrimet e subjektit të rregulluar dhe shoqërisë së transportit detar për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të GES-it, sipas pikave 1 deri 4 të nenit 8 dhe të pikave 3 deri 4 të nenit 12 të këtij ligji, fillojnë më 1 janar 2028.

7. Detyrimi për monitorimin dhe vlerësimin e progresit për zbatimin e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, sipas pikës 4 të nenit 5 të këtij ligji, fillon nga data 15 mars 2027.

8. Detyrimi për rishikimin e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën, sipas shkronjës “c” të pikës 5 të nenit 5 të këtij ligji, fillon nga data 1 janar 2028.

9. Detyrimi i AKM-së për hartimin e raportit për zbatimin e kërkesave për monitorimin, raportimin, verifikimin e shkarkimeve të GES-eve, sipas nenit 36 të këtij ligji, fillon një vit pas fillimit të efekteve të detyrimit të operatorit të instalimit, sipas pikës 1 të nenit 38/1 të këtij ligji.

Neni 39 **Shfuqizime**

Në shtojcën e vendimit nr. 1189, datë 18.11.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, pika 1 e ndarjes “Ç”, “Treguesit mjedisorë të trysnisë në mjedis”, shfuqizohet.

Neni 40 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.12.2020.
Shpallur me dekretin nr. 11893 , datë 5.1.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

SHTOJCA I GAZET ME EFEKT SERRË, QË REFEROHEN NË NENIN 2, PARAGRAFI 11

1. Dyoksid karboni (CO₂)
2. Metan (CH₄)
3. Monoksid azoti (N₂O)
4. Hegzafluorid i squfurit (SF₆)
5. Trifuorid azoti (NF₃)
6. Hidrofluorokarbone (HFCs) dhe
 - HFC-23 CHF₃
 - HFC-32 CH₂F₂
 - HFC-41 CH₃F
 - HFC-125 CHF₂CF₃
 - HFC-134 CHF₂CHF₂
 - HFC-134a CH₂FCF₃
 - HFC-143 CH₂FCHF₂
 - HFC-143a CH₃CF₃
 - HFC-152 CH₂FCH₂F
 - HFC-152a CH₃CHF₂
 - HFC-161 CH₃CH₂F
 - HFC-227ea CF₃CHFCF₃
 - HFC-236cb CF₃CF₂CH₂F
 - HFC-236ea CF₃CHFCHF₂
 - HFC-236fa CF₃CH₂CF₃
 - HFC-245fa CHF₂CH₂CF₃
 - HFC-245ca CH₂FCF₂CHF₂

- HFC-365mfc CH₃CF₂CH₂CF₃
- HFC-43-10mee CF₃CHFCHFCF₂CF₃ or (C₅H₂F₁₀)

7. Perfluorokarbone (PFCs):

- PFC-14, Perfluoromethane, CF₄
- PFC-116, Perfluoroethane, C₂F₆
- PFC-218, Perfluoropropane, C₃F₈
- PFC-318, Perfluorocyclobutane, c-C₄F₈
- Perfluorocyclopropane c-C₃F₆
- PFC-3-1-10, Perfluorobutane, C₄F₁₀
- PFC-4-1-12, Perfluoropentane, C₅F₁₂
- PFC-5-1-14, Perfluorohexane, C₆F₁₄
- PFC-9-1-18, C₁₀F₁₈

SHTOJCA II

PJESA A

LISTA E AKTIVITETEVE TË INSTALIMEVE DHE GES-et QË U NËNSHTROHEN DETYRIMEVE MRVA (Ndryshuar me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

1. Instalimet ose pjesët e instalimeve të përdorura për kërkimin, zhvillimin dhe testimin e produkteve e proceseve të reja dhe instalimet, të cilat në pesë vitet e fundit, bazuar mbi raportimet, më shumë se 95% të shkarkimeve e kanë nga përdorimi i biomasës janë të përjashtuara nga ky ligj.

2. Vlerat-prag, që jepen më poshtë, përgjithësisht u referohen kapaciteteve prodhuese ose vëllimit të prodhimit. Për aktivitetet që bien nën të njëjtën kategori dhe kryhen në të njëjtin instalim, kapacitetet e tyre mbledhen së bashku.

3. Për llogaritjen e inputit termal nominal total të një instalimi, ku digjen lëndë djegëse, mbledhen inputet termale nominale të të gjitha njësive teknike që janë pjesë e tij. Këto njësi mund të përfshijnë të gjitha tipat e bojlerëve, të pajisjeve për djegie, turbinave, pajisjeve ngrohëse, furnaltave/kaldajave, inceneratorëve, kalcinatorëve, furrave të çimentos, furrave të pjekjes, pajisjeve tharëse, motorëve, qelizave të lëndës djegëse, njësive të djegies me fryrje kimike, flakëruesve dhe njësive termale apo katalitike pas djegies. Në këtë llogaritje nuk do të merren në konsideratë njësitë me input nominal termal nën 3 mw.

4. Kur rezulton se në një instalim që ka një leje mjedisi, kapërcehet pragu i kapacitetit të një aktiviteti që listohet në këtë shtojcë, leja e mjedisit e të gjitha njësive, ku digjet lëndë djegëse, përveç njësive për incinerimin e mbetjeve të rrezikshme ose bashkiake, do të ketë edhe kërkesa për shkarkimet e GES-eve, sipas nenit 5 të këtij ligji.

Nr.	Aktivitetet	GES
1	Djegia e lëndëve djegëse në instalime, përfshirë dhe incenerimin e mbetjeve bashkiake (përveç instalimeve për incenerimin e mbetjeve të rrezikshme) me input terminal nominal mbi 20 mw	Dyoksid karboni
2	Rafinimi i naftës bruto kur përdoren njësi djegëse me input terminal nominal mbi 20 mw	Dyoksid karboni
3	Prodhimi i koksit	Dyoksid karboni
4	Pjekja ose aglomerimi, i xeherorëve metalikë, përfshirë xeherorët sulfidë, përfshirë peletizimin e tyre.	Dyoksid karboni
5	Prodhimi i hekurit ose çelikut (shkrijë primare dhe sekondare), përfshirë derdhjen e vazhdueshme me kapacitet	Dyoksid karboni

	prodhues më të madh se 2,5 tonë/orë	
6	Prodhimi ose përpunimi i metaleve ferrozë, përfshirë aliazhet e tyre, me njësi djegëse që operojnë me input terminal nominal mbi 20 mw. Përpunimi i metaleve ferrozë përfshin mullinjtë me rula, ngrohësit e ndërmjetëm, furnaltat, kovaçanat, fonderitë, veshjen me metal të shkrirë dhe fiskimin e ngjyrës/elektrolitik.	Dyoksid karboni
7	Prodhimi i aluminit primar ose oksideve të aluminit	Dyoksid karboni dhe perfluorokarbonet
8	Prodhimi i aluminit sekondar me njësi djegëse që operojnë me input terminal nominal mbi 20 mw.	Dyoksid karboni
9	Prodhimi apo përpunimi i metaleve joferoze, përfshirë prodhimin e aliazheve, rafinimin, derdhjen në fonderi etj., me njësi djegëse që operojnë me input terminal nominal mbi 20 mw (përfshirë lëndët djegëse që përdoren si agjentë reduktues).	Dyoksid karboni
10	Prodhimi i klinkerit të çimentos në furra rrotulluese me kapacitet prodhues mbi 500 tonë/ditë ose në furnalta të tjera me kapacitet prodhues mbi 50 tonë/ditë.	Dyoksid karboni
11	Prodhimi i gëlqeres apo kalcinimi i dolomitëve apo magnezitit në furra rrotulluese apo në furnalta të tjera me kapacitet prodhues mbi 50 tonë/ditë.	Dyoksid karboni
12	Prodhimi i qelqit dhe fibrave të qelqit me kapacitet shkrirjeje mbi 20 ton/ditë.	Dyoksid karboni
13	Prodhimi i produkteve qeramike nëpërmjet pjekjes, përfshirë tjegullat, tullat, tullat refraktare, pllakat, prodhimet e poçerisë/qeramikës apo të porcelanit me kapacitet prodhues mbi 75 tonë/ditë.	Dyoksid karboni
14	Prodhimi i materialeve izoluese me bazë leshi mineral, duke përdorur qelq, gurë apo skorie me kapacitet shkrirje mbi 20 tonë/ditë.	Dyoksid karboni
15	Tharja ose kalcinimi i gipsit apo prodhimi i fletëve/pllakave/paneleve prej gipsi, ku kapaciteti prodhues i gipsit të kalcinuar apo gipsit sekondar të tharë është mbi 20 tonë/ditë	Dyoksid karboni
16	Prodhimi i pulpës nga trungjet e drurit dhe materiale të tjera fibroze	Dyoksid karboni
17	Prodhimi i letrës dhe/ose i kartonit me kapacitet prodhues mbi 20 tonë/ditë	Dyoksid karboni
18	Prodhimi i katranit nga karbonizimi i substancave organike, të tilla, si: vajra, zift, tepricat e krekingut dhe distilimit, me kapacitet prodhues mbi 50 tonë/ditë	Dyoksid karboni
19	Prodhimi i acidit nitrik	Dyoksid karboni dhe oksid azoti
20	Prodhimi i acidit adipik	Dyoksid karboni dhe oksid azoti
21	Prodhimi i acidit glioksal dhe glioksilik	Dyoksid karboni dhe oksid azoti
22	Prodhimi i amoniakut	Dyoksid karboni
23	Prodhimi i shumicës së kimikateve organike përmes krekingut, reformimit, oksidimit të pjesshëm apo të plotë apo proceseve të ngjashme, me kapacitet prodhues mbi 100 tonë/ditë	Dyoksid karboni
24	Prodhimi i hidrogjenit (H ₂) dhe gazit të sintezës përmes reformimit apo oksidimit të pjesshëm me kapacitet prodhues mbi 5 tonë/ditë	Dyoksid karboni
25	Prodhimi i hirit të sodës (Na ₂ CO ₃) dhe bikarbonatit të sodës (NAHCO ₃)	Dyoksid karboni
26	Kapja e rrymave të GES-eve nga instalimet që mbulohen nga ky ligj për qëllime të transportit dhe depozitimit gjeologjik në një vend depozitimi për të cilën AKM-ja ka lëshuar një leje mjedisi	Dyoksid karboni
27	Transportimi i GES-eve përmes tubacioneve për depozitimin	Dyoksid karboni

	gjeologjik në një vend depozitimi për të cilin AKM-ja ka lëshuar një leje mjedisi, përjashtuar rastet kur këto shkarkime mbulohen nga një aktivitet tjetër nën këtë ligj	
28	Depozitimi gjeologjik i GES-eve në një vend depozitimi për të cilin AKM-ja ka lëshuar një leje mjedisi	Dyoksid karboni

PJESA B
LISTA E AKTIVITETEVE TË AVIACIONIT DHE GES,
QË U NËNSHTROHEN DETYRIMEVE MRVA, SIPAS KREUT III TË LIGJIT
(Ndryshuar me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

Nr.	Aktivitetet	GES
	Fluturimet ndërmjet aerodromeve që ndodhen në dy shtete të ndryshme, që janë pjesë e zonës ekonomike evropiane, Mbretërisë së Bashkuar dhe Zvicrës, si dhe vendeve që zbatojnë skemën <i>CORSLA</i>, dhe çdo fluturim tjetër ndërmjet aerodromeve që ndodhen në dy vende të treta, të ndryshme nga operatorët e avionëve, që plotësojnë të gjitha kushtet e mëposhtme: a) Operatorët e avionëve kanë një certifikatë operatori ajror të lëshuar nga një autoritetet shqiptare janë të regjistruar në autoritetet shqiptare; dhe b) Ata prodhojnë shkarkime vjetore të CO₂ më të mëdha se 10.000 tonë nga përdorimi i avionëve, me një masë maksimale ngritjeje të certifikuar më të madhe se 5.700 kg, që kryejnë fluturime që janë pjesë e kësaj shtojce, përveç atyre që nisen dhe mbërrijnë brenda territorit shqiptar, nga 1 janari 2021; për qëllimet e kësaj pike, shkarkimet nga llojet e mëposhtme të fluturimeve do të jenë të përjashtuara: i. fluturimet shtetërore; ii. fluturimet humanitare; iii. fluturimet mjekësore; iv. fluturimet ushtarake; v. fluturimet për shuarjen e zjarrit; vi. fluturimet që paraprijnë ose pasojnë një fluturim humanitar, mjekësor ose zjarrfikës, me kusht që fluturime të tilla të kryheshin me të njëjtin avion dhe kërkohen për të kryer aktivitetet përkatëse humanitare, mjekësore ose zjarrfikëse ose për të ripozicionuar avionin pas këtyre aktiviteteve për aktivitetin e tij të ardhshëm.	Dyoksid karboni
	Fluturimet që nisen ose mbërrijnë në një aerodrom që ndodhet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Nga këto fluturime do të përjashtohen: a) fluturimet që kryhen ekskluzivisht për transportin për misione zyrtare të një monarku në fuqi dhe familjes së ngushtë të tij, të kryetarëve të shteteve dhe ministrave të vendeve të huaja, kur një gjë e tillë është treguar në planin e fluturimit; b) fluturimet ushtarake që kryhen nga avionë ushtarakë dhe fluturimet e autoriteteve të doganave dhe të policisë; c) fluturimet për misione kërkimi dhe shpëtimi për shuarje zjarresh, fluturimet humanitare dhe shërbime shëndetësore emergjente të autorizuara nga autoritetet kompetente përkatëse; ç) çdo fluturim që kryhet ekskluzivisht sipas rregullave të shikueshmërisë së fluturimit, sipas përcaktimit të bërë në shtojcën 2, të Konventës së Çikagos; d) fluturimet që përfundojnë në aerodromin e nisjes, pa bërë asnjë ulje të ndërmjetme; dh) fluturimet për trajnim që kryhen ekskluzivisht për marrjen e licencës apo për vlerësim në rastin e ekuipazhit të fluturimit, kur kjo është përcaktuar me shënimin e duhur në planin e fluturimit, me kusht që ai fluturim të mos shërbejë për transportin e pasagjerëve dhe/ose mallrave apo për pozicionimin, apo transferimin e avionit; e) fluturimet që kryhen ekskluzivisht për qëllime të kërkimit shkencor apo për kontrollimin, testimin apo certifikimin e avionit apo pajisjeve, qoftë në	Dyoksid karboni

ajër apo në tokë; ë) fluturimet që kryhen nga një avion që ka masë maksimale ngritjeje të certifikuar prej më pak se 5,700 kg; f) fluturimet që kryhen mbi rrugët ajrore, kur kapaciteti i ofruar nuk është më i madh se 50.000 vende në vit; g) fluturimet që, përveçse në këtë rast, do të binin në aktivitetin e kryer nga një operator tregtar transporti ajror që operon ose: - më pak se 243 fluturime në periudhë, për 3 periudha katërmujore të njëpasnjëshme; - fluturimet me shkarkime totale vjetore më të ulëta se 10.000 tonë në vit. Fluturimet që përfshihen në shkronjat “h” dhe “i” ose që kryhen ekskluzivisht për transportin për misione zyrtare të një monarku në fuqi dhe familjes së ngushtë të tij, të kryetarëve të shteteve dhe ministrave të shqiptar, nuk mund të përjashtohen sipas kësaj pike; gj) nga 1 janari 2013 deri më 31 dhjetor 2030, fluturime të cilat, nëse nuk do të ishte për këtë pikë, do të përfshiheshin në këtë aktivitet, të kryera nga një operator avioni jotregtar që kryen fluturime me shkarkime totale vjetore më të ulëta se 1.000 tonë në vit (duke përfshirë shkarkimet nga fluturimet e përmendura në shkronjat “h” dhe “i”); h) fluturimet nga aerodromet e vendosura në Zvicër në aerodromet e vendosura në Shqipëri; i) fluturimet nga aerodromet e vendosura në Mbretërinë e Bashkuar në aerodromet e vendosura në Shqipëri.	
--	--

PJESA C

LISTA E ANIJEVE, AKTIVITETEVE TË TRANSPORTIT DETAR DHE GES-et QË U NËNSHTROHEN DETYRIMEVE MRVA, SIPAS KREUT III TË LIGJIT (Shtuar me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

Llojet e anijeve dhe aktivitetet	GES
- Anijet me tonazh 5000 GT dhe mbi 5000 GT për shkarkimet GES gjatë udhëtimeve të kryera për transportin e mallrave dhe pasagjerëve për qëllime tregtare, që udhëtojnë nga porti i fundit i zbarkimit të anijes drejt një porti zbarkimi në Republikën e Shqipërisë dhe nga një port zbarkimi i Republikës së Shqipërisë drejt portit të ardhshëm të zbarkimit, si dhe ndërmjet porteve të zbarkimit brenda Republikës së Shqipërisë. - Anijet me tonazh nën 5000 GT deri në 400 GT, por jo më të vogla se 400 GT, për shkarkimet GES gjatë udhëtimeve të kryera për transportin e mallrave me qëllime tregtare, që udhëtojnë nga porti i fundit i zbarkimit drejt një porti zbarkimi në Republikën e Shqipërisë dhe nga një port zbarkimi në Republikën e Shqipërisë në portin e ardhshëm të zbarkimit, si dhe ndërmjet porteve të zbarkimit brenda Republikës së Shqipërisë. - Anijet në det të hapur (<i>offshore</i>) me tonazh 5000 GT dhe mbi 5000 GT për shkarkimet GES që udhëtojnë nga porti i fundit i zbarkimit drejt një porti zbarkimi në Republikën e Shqipërisë dhe nga një port zbarkimi në Republikën e Shqipërisë në portin e ardhshëm të zbarkimit, si dhe ndërmjet porteve të zbarkimit brenda Republikës së Shqipërisë. - Anijet në det të hapur (<i>offshore</i>) me tonazh nën 5000 GT deri në 400 GT, por jo më të vogla se 400 GT, për shkarkimet GES, që udhëtojnë nga porti i fundit i zbarkimit drejt një porti zbarkimi në Republikën e Shqipërisë dhe nga një port zbarkimi në Republikën e Shqipërisë në portin e ardhshëm të zbarkimit, si dhe ndërmjet porteve të zbarkimit brenda Republikës së Shqipërisë. Përjashtohen nga kjo listë anijet luftarake, mjetet ndihmëse detare, anijet e peshkimit ose për përpunimin e peshkut, anijet prej druri të një ndërtimi të thjeshtë, anijet që nuk lëvizin me mjete shtytëse mekanike ose anijet geveritare, të përdorura për qëllime jotregtare.	Dyoksid karboni Metan (CH₄) Protoksidi i azotit (N₂O)

PJESA D
LISTA E AKTIVITETEVE TË SUBJEKTIT TË RREGULLUAR, QË U
NËNSHTROHEN DETYRIMEVE MRVA, SIPAS KREUT III TË LIGJIT
(Shtuar me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

Aktivitetet	GES
Hedhja në treg e lëndëve djegëse, të cilat përdoren për djegie në ndërtesa, transport rrugor dhe sektorë të tjerë. Konsiderohet si lëndë djegëse, për qëllimin e këtij ligji, çdo produkt energjetik, sipas karakteristikave të mëposhtme: i. i klasifikuar në krerët 1507 deri 1518 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave (NKM), kur synohet të përdoret si lëndë djegëse motorike ose karburant për ngrohje; ii. i klasifikuar në krerët NKM 2701, 2702 dhe nga 2704 deri në 2715; NKM 2901 dhe 2902; NKM 3403; NKM 3811; NKM 3817; iii. i klasifikuar në krerët NKM 2905 11 00, që nuk kanë origjinë sintetike dhe që janë të destinuara të përdoren për lëndë djegëse motorike ose karburant për ngrohje; iv. i klasifikuar në krerët NKM 3824 99 86, 3824 99 92, 3824 99 93 , 3824 99 96 (përjashtuar përgatitjet antindryshk që përmbajnë amina, si përbërës aktiv dhe tretësit inorganik kompozit dhe holluesit për llaqet dhe produkte të ngjashme), 3826 00 10 dhe 3826 00 90, nëse janë të destinuara të përdoren si lëndë djegëse motorike ose karburant për ngrohje; v. karburant me përmbajtje plumbi, klasifikuar në krerët NKM 2710 12 31, 2710 12 50 ; vi. karburant pa përmbajtje plumbi, klasifikuar në krerët NKM 2710 12 31, 2710 12 41, 2710 12 45 dhe 2710 12 49 vii. gazoil, klasifikuar në krerët NKM nga 2710 19 42 deri në 2710 19 67 dhe nga 2710 20 32 deri në 2710 20 38; viii. vajguri, si lëndë djegëse e tipit Jet dhe lloje të tjera, klasifikuar në krerët NKM 2710 19 21 dhe 2710 19 25; ix. gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike të lëngshme, pa përfshirë gazin natyral, klasifikuar në krerët NKM nga 2711 12 11 deri në 2711 19 00; x. gaz natyror, klasifikuar në krerët NKM 2711 11 00 dhe 2711 21 00; xi. vajrat e rënda, klasifikuar në krerët NKM nga 2710 19 62 deri në 2710 19 67 dhe nga 2710 20 32 deri në 2710 20 38; xii qymyr dhe koks, klasifikuar në krerët NKM 2701, 2702 dhe 2704; xiii. energji elektrike, klasifikuar në krerët NKM 2716; xiv. si dhe çdo produkt tjetër i destinuar për përdorim, i ofruar për shitje apo që përdoret si lëndë djegëse motorike ose lëndë djegëse për ngrohje, përfshirë përdorimin për prodhimin e energjisë elektrike. Ky aktivitet nuk përfshin: a) hedhjen në treg të lëndëve djegëse të përdorura në aktivitetet e radhitura në shtojcën II, pjesa A, përveç nëse përdoret për djegie në aktivitetet e transportit të GES për depozitimin gjeologjik, siç përcaktohet në pikën 27 të shtojcës II, pjesa A ose nëse përdoret për djegie në instalimet që shkarkojnë më pak se 2 500 tonë ekuivalent të dyoksidit të karbonit në vit; b) hedhjen në treg të lëndëve djegëse për të cilat faktori i shkarkimit është zero; c) hedhjen në treg të mbetjeve të rrezikshme ose bashkiake të përdorura si lëndë djegëse. Sektori i ndërtesave dhe transportit rrugor do të korrespondojnë me burimet e mëposhtme të shkarkimeve, të përcaktuara në udhëzimet e vitit 2006 për inventarët kombëtarë të GES-eve, të hartuara nga Paneli ndërqeveritar për ndryshimet klimatike (IPCC) i OKB-së , me modifikimet e nevojshme për këto përkufizime si më poshtë: a) Prodhimi i kombinuar i ngrohjes dhe energjisë (CHP) (kodi burimor 1A1a ii) dhe impiantet e nxehtësisë (kodi burimor 1A1a iii), për aq sa prodhojnë nxehtësi për kategoritë, sipas shkronjave “c” dhe “d” të këtij paragrafi, ose drejtpërdrejt, ose përmes rrjeteve të ngrohjes qendrore.	Dyoksid karboni
b) Transporti rrugor (kodi burimor 1A3b), duke përjashtuar përdorimin e mjeteve	Dyoksid karboni

bujqësore në rrugët e asfaltuara; c) Tregtar/institucional (kodi burimor 1A4a); d) Rezidenciale (kodi i kategorisë burimore 1A4b). Sektorët e tjerë do t'u përkasin burimeve të mëposhtme të shkarkimeve, të përcaktuara në udhëzimet e IPCC-së të vitit 2006 për inventarët kombëtarë të GES-eve: a) Industrinë energjetike (kodi burimor 1A1), duke përfshirë kategoritë e përcaktuara në paragrafin e dytë, shkronja "a", të kësaj shtojce; b) Industrinë e prodhimit (<i>manufacturing</i>) dhe ndërtimit (kodi burimor 1A2).	
--	--

SHTOJCA III – A

(Ndryshuar me ligjin nr. 95/2025, datë 18.12.2025)

PJESA 1

LISTA JOSHTERUESE E ÇËSHTJEVE QË DUHEN TRAJTUAR NË STRATEGJINË KOMBËTARE AFATGJATË PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE ZHVILLIMIN ME EMETIM TË ULËT (SKA-NKZHEU)

1. SKA-NKZHEU, e miratuar në përputhje me parashikimet e nenit 5 të këtij ligji:

i. bazohet në një vizion strategjik afatgjatë, që merr parasysh objektivat dhe prioritetet kryesore të vendit dhe është në përputhje me qëllimet afatgjata të marrëveshjes së Parisit;

ii. është plotësisht në përputhje me NDC-në, qëllimet dhe politikat e tjera të dekarbonizimit dhe zhvillimit, e integruar në kontekstin më të gjerë të vendit.

iii. zhvillohet dhe koordinohet përmes proceseve ndërsektoriale dhe angazhimit të palëve të interesuara.

SKA-NKZHEU dhe plani i veprimit, përveç elementeve të parashikuara në pikën 2 të nenit 14 të këtij ligji, përmban elementet e mëposhtme:

1.1. Vlerësimin e ndryshimeve klimatike në Republikën e Shqipërisë që përfshin:

a) Vlerësimin e ndikimeve të ndryshimeve klimatike në mjedis, shoqëri dhe shëndet;

b) Vlerësimin e ndikimeve të ndryshimeve klimatike të burimet ujore, bujqësia dhe blegtoaria dhe sektorët që ndikohen më shumë;

c) Vlerësimin e ndikimeve të ndryshimeve klimatike të grupet dhe komunitetet e cënueshme, tek ekosistemet, të burimet ujore, të bujqësia, të blegtoaria, të zonat e mbrojtura dhe të sektorët që ndikohen më tepër;

ç) Ndryshimet klimatike të pritshme në të ardhmen në territorin e Shqipërisë;

d) Politikat afatgjata ndaj ndryshimeve klimatike për mbrojtjen e njeriut, mjeteve të jetesës dhe ekosistemeve.

1.2. Pasqyrën e politikave, kuadrit ligjor dhe institucional ekzistues për zbatimin masave në fushën e ndryshimeve klimatike

1.3. Objektivat dhe synimet e përgjithshme të Strategjisë, duke përfshirë:

a) masat dhe aktivitetet prioritare, bazuar në vlerësimin e ndikimeve të ndryshimeve klimatike;

b) strategjinë afatgjatë për zhvillimin me emetim të ulët, në përmbushje të parashikimeve të pikës 19 të nenit 4 të marrëveshjes së Parisit dhe të pikës 2 të nenit 14 të këtij ligji;

c) detyrimet ndërkombëtare dhe bashkëpunimin ndërkombëtar të Shqipërisë, në kuadër të ndryshimeve klimatike.

1.4. Planin e veprimit të SKA-NKZHEU, si pjesë përbërëse e Strategjisë, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të këtij ligji, përmban të paktën elementet e mëposhtme:

i. Pasqyrën e përgjithshme:

a) përshkrimin e objektiveve dhe masave zbutëse/mitiguese;

b) bashkërendimin me planet kombëtare ekzistuese, si dhe me qëllimet për zbutjen/mitigimin sektorial;

c) përshkrimin e nismave dhe sinergjive ekzistuese për mitigimin.

ii. Përfitimet:

- a) përshkrimi i përfitimeve në aspektin e zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe mjedisor;
- b) analizën e shpenzimeve – përfitimeve nga zbatimi i masave zbutëse/mitiguese;

iii. Ndikimet nga emetimi i gazit serrë:

- a) përshkrimin e skenarit “*business as usual*” (referuar si “BAU”);
- b) përshkrimin e ndikimeve të vlerësuara mbi devijimin e emetimit të gazit serrë nga BAU;
- c) përshkrimin e impaktit transformues pas zbatimit;
- ç) analizën e shpenzimeve – përfitimeve në arritjen e ndikimeve të emetimit të gazit serrë.

iv. Plan-veprimin:

- a) përshkrimin e aktiviteteve specifike për zbatimin e masave zbutëse/mitiguese të planit;
- b) planin e punës për mënyrën e zbatimit të aktiviteteve specifike dhe afatet përkatëse;
- c) planin për pjesëmarrjen e palëve të interesuara, përfshirë rolin e çdo pale në zbatimin e aktiviteteve dhe marrëveshjet institucionale.

v. Monitorimin dhe matjen e progresit:

- a) parametrat dhe treguesit kryesorë të vlerësimit të zbatimit të planit;
- b) parametrat dhe treguesit kryesorë të vlerësimit të përfitimeve kombëtare dhe ndikimet e emetimit të gazit serrë;
- c) metodologjinë e vlerësimit të ndikimeve të emetimit të gazit serrë, si dhe marrëveshjet për matjen dhe raportimin.

1.5. Planin për financimin e SKA-NZHEU-së, që përmban të paktën elementet e mëposhtme:

a) vlerësimin gjithëpërfshirës të humbjes ekonomike dhe joekonomike dhe dëmeve të lidhura me ndryshimin e klimës, përfshirë ato të shkaktuara nga situatat emergjente, si dhe ngjarjet me fillim të ngadalshëm (*slow onset events*);

b) planin e veprimit për menaxhimin e riskut, përfshirë sistemet e paralajmërimit të hershëm, gatishmërisë emergjente dhe masave që synojnë përmirësimin e qëndrueshmërisë së komuniteteve, jetesës dhe ekosistemeve;

c) masat e menaxhimit të riskut financiar, përfshirë lehtësirat e sigurimit të riskut, bashkimit të risqeve të klimës (*climate risk pooling*) ose zgjidhje të tjera të sigurimit.

1.6. Masat specifike për rritjen e kapaciteteve të institucioneve që ushtrojnë detyra dhe kompetenca në kuadër të pasojave të ndryshimeve klimatike.

1.7. Burimet financiare të nevojshme për zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe planeve kombëtare për ndryshimet klimatike.

1.8. Masat për edukimin, trajnimin, ndërgjegjësimin ndaj ndryshimeve klimatike, përfshirë nxitjen dhe mbështetjen e kërkimeve shkencore në fushën e ndryshimeve klimatike.

PJESA 2

LISTA JOSHTERUESE E ÇËSHTJEVE QË DUHEN TRAJTUAR NË PLANIN KOMBËTAR TË PËRSHTATJES

Plani Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP), që parashikohet në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 5 të këtij ligji, përmban të paktën elementet e mëposhtme:

i. Pasqyrën e përgjithshme:

- a) përshkrimi i objektivave dhe masave për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;
- b) bashkërendimi dhe integrimi i politikave të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike të planit dhe strategjitë kombëtare ekzistuese;

ii. Përfitimet:

- a) përshkrimi i përfitimeve në aspektin e zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe mjedisor;
- b) analiza e shpenzimeve – përfitimeve nga zbatimi i masave të përshtatjes;

iii. Plan-veprimin:

a) përshkrimi i aktiviteteve specifike për zbatimin e masave të përshtatjes;
b) plani i punës për zbatimin e aktiviteteve specifike dhe afatet përkatëse;
c) plani për pjesëmarrjen e palëve të interesuara, përfshirë rolin i çdo pale në zbatimin e aktiviteteve dhe marrëveshjet institucionale.

iv. Monitorimin dhe matjen e progresit:

a) parametrat dhe treguesit kryesorë të vlerësimit të zbatimit të planit;

b) metodologjia e vlerësimit.

SHTOJCA III-B

LISTA JOSHTERUESE E ÇËSHTJEVE QË DUHEN TRAJTUAR NË DOKUMENTET STRATEGJIKE SEKTORIALE QË REFEROHEN NË NENIN 5

1. Përshkrimin e kontekstit socio-ekonomik, demografik dhe gjeografik për zhvillime me pak karbon.

2. Vlerësimin e shkarkimeve ekzistuese të GES-it, sipas sektorëve dhe shkarkimet e pritshme në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

3. Vlerësimin e opsioneve teknologjike në sektorë prioritarë.

4. Analizën e mundësive të zbatimit të opsioneve për zhvillime me pak karbon në sektorë të rëndësishëm.

5. Zgjedhjen e opsioneve të duhura për t'u zbatuar në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, në mënyrë që të plotësohen objektivat e përcaktuar në NDC, të referuara në nenin 5.

6. Koordinimin dhe sinergjinë me marrëveshje mjedisore ndërkombëtare/shumëpalëshe, proceset dhe mundësitë për financim.